



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 42/2022 regjistër (JR)
Datë 22.09.2022

Nr. 38 i vendimit
Datë 13.05.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Rezarta Schuetz	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 13.05.2025, ditën e martë, ora 10.00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar z. Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Jerina Gjika, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Astrit Halilaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 545, datë 30.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Jurisprudenca e kësaj Gjykate; neni 42 dhe nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës të Shqipërisë”; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Halilaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit pranë Prokurorisë së Gjykatës Rrethit Gjyqësor Shkodër, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
 - 2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë¹ së subjektit të rivlerësimit Astrit Halilaj, duke konkluduar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *ka kryer deklaram të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.
 - 2.2. DSIK-ja vuri në dispozicion të Komisionit Raportin për kontrollin e figurës², për subjektin e rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Halilaj.
 - 2.3. KLP-ja ka përcjellë në Komision Raportin³ për vlerësimin e aftësive profesionale, për subjektin e rivlerësimit Astrit Halilaj.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 545, datë 30.06.2022, vendosi: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Halilaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*” [...]. Ky vendim është marrë sipas konkluzioneve për secilin prej kritereve të rivlerësimit, si më poshtë:

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 27.11.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Astrit Halilaj, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”.

² Raporti nr. {***} prot., datë 27.10.2017, gjithashtu Komisionit i është komunikuar nga DSIK-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 17.02.2021, se raporti i sipërcituar është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 16.02.2021, të KDZH-së.

³ Raporti i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga KLP-ja me nr. {***}, prot., datë 16.11.2021.

3.1. Në lidhje me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe deklarimit të pasurisë dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 3 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

3.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit Astrit Halilaj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

3.3. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit Astrit Halilaj ka arritur një nivel kualifikues, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

4. Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, me vendimin nr. 545, datë 30.06.2022, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Halilaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër” [...].

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit Astrit Halilaj, në datën 08.09.2022, ka ushtruar ankim kundër vendimit nr. 545, datë 30.06.2022, të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji: (i) shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe çeljen e hetimit gjyqësor, përsëritjen e shqyrtimit të provave të dosjes së rivlerësimit, pranimin dhe shqyrtimin e provave të reja bashkëlidhur ankimit; (ii) ndryshimin e vendimit dhe konfirmimin e tij në detyrë.
6. **Lidhur me aspektet procedurale dhe parimet e procesit të rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, pretendon se:**

6.1. Komisioni ka nxjerrë konkluzione në shkelje të parimeve themelore procedurale dhe të ligjshmërisë, pasi ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 dhe 179/b, pika 2 e Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.

6.2. Komisioni, jo vetëm që nuk ka marrë në konsideratë provat e paraqitura nga subjekti, për burimet e ligjshme të pasurisë së personave që i ka konsideruar si persona të lidhur me subjektin, por dhe i ka mohuar atij të drejtën për t'i diskutuar këto prova në funksion të një mbrojtjeje efektive, duke cenuar dukshëm parimin e kontradiktoritetit në një proces të rregullt ligjor. Sipas subjektit, kjo mënyrë e të vepruarit të Komisionit është në kundërshtim të hapur me parimin për një gjykim të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe të pandikuar nga faktorë të tjerë.

Gjithashtu, Komisioni nuk ka respektuar as procedurën e vlerësimit të provave të paraqitura sipas kërkesave të nenit 48 të Kodit të Procedurës Administrative. Sipas subjektit, Komisioni, duke mos marrë në konsideratë provat e paraqitura që lidhen me burimin e ligjshëm të huas prej 10.000 eurosh, të marrë nga kunati F. Ç., ka cenuar parimin e barazisë së armëve, mbrojtjes efektive dhe të drejtën për një proces të rregullt dhe ligjor.

6.3. Subjekti i rivlerësimit, duke iu referuar 4 (katër) kritereve të përcaktuara në vendimin e GjEDNj-së në çështjen *Volkov v Ukrainë*, për përcaktimin e organit që vendos masa disiplinore, pretendon se Komisioni ka cenuar nenin 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për sa i përket formimit të trupit gjykues pa garancitë e nevojshme për pavarësi dhe paanshmëri. Sipas subjektit, trupi gjykues që ka kryer hetimin dhe gjykimin e tij, nuk ka asnjë gjyqtar në përbërjen e tij. Anëtarët

e Komisionit janë emëruar nga Kuvendi i Shqipërisë në një proces të mirëfilltë politik, duke caktuar në këtë detyrë persona të njohur për lidhjet e ngushta politike. Anëtarët e Komisionit që kanë dhënë vendimin, janë të njëjtët që kanë kryer hetimin administrativ ndaj tij, duke cenuar në këtë mënyrë, sipas subjektit, parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme.

6.4. Subjekti pretendon se Komisioni ka cenuar parimin e shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, lidhur me respektimin e nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për barrën e provës. Sipas subjektit, barra e provës i kalon atij, vetëm kur ai kërkon të provojë se dokumentet dhe provat e siguruar nga Komisioni nuk pasqyrojnë vërtetësi për sa i përket tre komponentëve të rivlerësimit, por sipas subjektit nuk ka rezultuar asnjë provë që të ketë arritur nivel provueshmërie që ndaj tij të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

6.5. Subjekti pretendon se Komisioni, në konkluzionet e tij për kriterin e vlerësimit të pasurisë, përveç një vlerësimi të gabuar të provave dhe interpretimit të tyre në kundërshtim me përmbajtjen dhe parashikimet ligjore, ka cenuar parimet e objektivitetit, proporcionalitetit dhe të sigurisë juridike. Sipas subjektit, Komisioni ka mbajtur qëndrime të ndryshme në çështje të ngjashme, duke konfirmuar në detyrë subjektet e tjera, megjithëse kanë pasur shuma monetare të pajustificuara nga të ardhurat nga emigracioni.

7. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Subjekti, fillimisht, në ankimin e tij për kriterin e kontrollit të pasurisë, kryen një interpretim të dispozitave ligjore lidhur me objektin e deklarimit të pasurisë, barrën e provës në kuadër të procesit të rivlerësimit, si dhe duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit dhe legjislacionit shpjegon konceptet dhe përkufizimet për ligjshmërinë e të ardhurave, deklarimin e rremë dhe fshehjen e pasurisë, mënyrën e deklarimit të pasurisë në deklaratat periodike dhe *vetting*, si dhe objektin të hetimit dhe vlerësimit të pasurisë për subjektet që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit.

7.1. Lidhur me pasurinë “banesë private 2 kate dhe kat nënçati”, të ndodhur në rrugën “{**}”, Tiranë,** subjekti i rivlerësimit pretendon se shpenzimet faktike për ndërtimin e këtij objekti janë shumë më pak se vlera prej 5.000.000 lekësh, e deklaruar prej tij në deklaratën *vetting*, të shpërndara ndër vite nga 1995 deri në 2014, pasi objekti është ndërtuar nga ai vetë me ndihmën e familjarëve (vëllezërve).

7.1/a. Subjekti pretendon se Komisioni ka arritur në një konkluzion të gabuar edhe në lidhje me kohën e përfundimit të katit të dytë dhe katit të tretë, duke e konsideruar të përfunduar objektin në vitin 2002, pasi sipas tij objekti në atë kohë ka qenë në fazën e karabinasë.

7.1/b. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që të merret në konsideratë edhe fakti se gjatë viteve 1995 – 1997, në vendin tonë, ka ekzistuar fenomeni i huadhënies në firmat piramidale, ku ai, si shumë persona të tjerë, ka gjeneruar të ardhura nga kjo veprimtari gjatë 2 (dy) viteve.

7.2. Lidhur me pasurinë “apartament banimi dhe vendparkim, në Vlorë”, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim provat e paraqitura prej tij lidhur me burimin e ligjshëm të huas prej 10.000 eurosh, dhënë nga kunati F. Ç., e cila ka shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie.

7.2/a. Subjekti pretendon se shuma prej 4.252 USD, e paguar në favor të firmës ndërtuese për të plotësuar këstin e parë prej 20.000 eurosh, për prenotimin e apartamentit në Vlorë, është tërhequr nga depozita në ProCredit Bank dhe vërtetohet me *statementin* e bankës, datë 07.07.2022.

7.2/b. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, ashtu siç ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, depozitat me vlerë 27.000 USD janë krijuar me remitancat nga puna në emigracion e vëllezërve të tij dhe përfshirja e këtyre fondeve në analizën e tij, do të përmbyste balancën negative në lidhje me krijimin e kështit të parë prej 20.000 eurosh, që janë përdorur për prenotimin e apartamentit në Vlorë.

7.2/c. Subjekti pretendon se Komisioni, në mënyrë të padrejtë, nuk ka përfshirë në mënyrë të saktë në analizën financiare për vitin 2010 të ardhurat e tij nga paga dhe të bashkëshortes, dhe kërkon nga Kolegji që të bëjë një përlogaritje të saktë, mbështetur në provat e administruara në lidhje me mundësinë financiare faktike të tij, për blerjen e apartamentit në Vlorë.

7.2/ç. Subjekti kundërshton analizën e kryer nga Komisioni në pikën nr. 39, lidhur me likuidimin e huas, pasi, sipas tij, kjo hua është likuiduar sipas kontratës së huas, ku huadhënësit i janë dorëzuar çdo vit nga 2000 euro, nga viti 2011 deri në vitin 2015. Sipas subjektit, likuidimet e huas janë deklaruar në DIPP-në 2011, 2012 dhe 2013, ndërsa për vitet e tjera nuk ka pasur detyrim për deklarim, pasi nuk ka qenë subjekt deklarues, deri në prill të vitit 2016, kur është emëruar në detyrën e prokurorit.

7.2/d. Lidhur me vendparkimin e blerë në vlerën 5.000 euro, në muajin gusht të vitit 2014, subjekti pretendon se balanca negative e konstatuar nga Komisioni, në vlerën prej -134.157 lekë, nuk qëndron, pasi Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e tjera që kanë shërbyer si burim për blerjen e vendparkimit, shumën prej 365.000 lekë, tërhequr nga bashkëshortja e tij nga llogaria e saj e depozitës.

7.3. Në lidhje me depozitat prej 27.000 USD, të depozituara në banka në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit pretendon se shuma prej 10.000 USD, e depozituar në ProCredit Bank dhe shuma prej 17.000 USD, e depozituar në Bankën Amerikane, janë fonde të krijuara nga puna në emigracion e vëllezërve të tij, të cilat i janë dorëzuar atij në formë të ndryshme, dorazi dhe me transferta nga Western Union. Subjekti kërkon që të ardhurat nga puna në emigracion e personave të lidhur dhe të depozituara në bankë, të përfshihen në analizën financiare, duke i konsideruar si burim të ligjshëm.

7.4. Lidhur me dy njësi shërbimi, ndodhur në Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se të drejtat reale mbi këto pasuri i kanë kaluar atij nga vëllai F. H., në vitin 2014, sipas një marrëveshjeje kompensimi, nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***}, datë 08.09.2014. Burimi i financimit të këtyre pasurive është nga puna në emigracion e vëllait në vitet 1999 – 2001, në Gjermani. Subjekti kërkon që shuma prej 32.000 USD, e përdorur në vitin 2000 për blerjen e pasurive, të përfshihet në analizën financiare si të ardhura nga burim i ligjshëm.

7.5. Lidhur me blerjen e automjetit tip “Mercedes - Benz”, subjekti i rivlerësimit pretendon se si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes - Benz” kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit tjetër tip “Mitsubishi Pajero” dhe Komisioni, në mënyrë të padrejtë, nuk e ka njohur si të ardhur të ligjshme diferencën ndërmjet çmimit të shitjes dhe blerjes, prej 766.500 lekësh, për automjetin tip “Mitsubishi”.

7.6. Në lidhje me të ardhurat nga paga, subjekti i rivlerësimit pretendon se, pas mbylljes së hetimit administrativ në Komision, ka arritur të marrë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimit Shëndetësor në

Tiranë, nga dosja e pensionit të tij si ushtarak, vërtetimin nr. {***} prot., datë 23.11.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për vjetërsinë e shërbimit dhe pagën mesatare neto referuese. Subjekti kërkon që kjo provë, të cilën nuk ka pasur mundësi ta paraqesë më parë, jo për fajin e tij, të administrohet dhe të vlerësohet nga Kolegji si provë e re, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, dhe këto të ardhura, të pasqyruara në këtë dokument, të përfshihen në analizën e tij financiare për vitin 1993.

Sipas subjektit, analiza financiare e tij është bërë për vitet 1995 – 2016, duke mos përfshirë të ardhurat nga paga për vitin 1993 dhe 1994, për shkak se nuk ishin gjetur borderotë. Subjekti kërkon që, në analizën në Kolegj, të përshihen të ardhurat nga paga në vitin 1994, pasi sipas shkresës nr. {***} prot., datë 28.10.2016, të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, të cilën e ka dorëzuar së bashku me deklaratën *vetting*, të ardhurat nga paga në vitin 1994 kanë qenë në shumën 80.736 lekë.

7.7. Në lidhje me udhëtimet jashtë shtetit, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që të administrohen si provë e re disa akte,⁴ që sipas tij ndikojnë në tabelën e shpenzimeve për udhëtimet jashtë shtetit. Gjithashtu, subjekti kërkon të merret në konsideratë informacioni i shkresës së Ministrisë së Brendshme, sipas së cilës, për vitet 2006 – 2008, nuk ka të dhëna arkivore dhe ta konsiderojë atë si pamundësi objektive të subjektit, të sigurimit të provave për shpenzimet e shërbimeve jashtë shtetit për periudhën 2006 – 2008.

7.8. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkon që Kolegji të kryejë një analizë të re financiare, duke u mbështetur në provat e administruara nga Komisioni dhe shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij në këtë ankim.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjyqimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*), për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, z. Astrit Halilaj, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë

⁴ Subjekti i rivlerësimit pretendon se, pas mbylljes së hetimit administrativ, Drejtoria e Arkivit në Ministrinë e Brendshme i ka dërguar atij, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 01.08.2022, kopje të urdhrave të Ministrit të Brendshëm, konkretisht urdhri nr. {***}, datë 16.09.2009, për dërgim me shërbim në Budva, Mali i Zi dhe urdhri nr. {***}, datë 26.10.2009, për dërgim me shërbim në Nova Gorica, Slloveni.

Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁵ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 545, datë 30.06.2022, të Komisionit, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
11. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”), shqyrtoi kërkesat e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe në parashtrime për marrjen e provave të reja, si dhe për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.
12. Lidhur me provueshmërinë e këtyre akteve, në këtë fazë të gjykimit në Kolegji, në zbatim të parashikimeve të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, procesi gjyqësor në Kolegji zhvillohet sipas një grupi dispozitash të ligjit nr. 49/2012, përfshirë nenet 47, 49 dhe 51 të këtij ligji. Sipas parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për sa u përket provave, vlerësimi i tyre dhe i akteve të administruara gjatë procesit të zhvilluar në Komision, është pjesë e qenësishme e procedurës së analizimit të shkaqeve të ankimit nga Kolegji.
13. Nga analizimi i akteve⁶ bashkëlidhur ankimit konstatohet se ato nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë pas dhënies së vendimit të Komisionit. Si rrjedhojë, nuk mund të argumentohet që paraqitja e tyre në Komision ka qenë e pamundur. Ky konstatim vlen edhe për aktet që mbajnë datat pas dhënies së vendimit, sikurse: shkresa nr. {***} prot., datë 01.08.2022, e Drejtorisë së Arkivit në

⁵ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 545, datë 30.06.2022, për rivlerësimin e subjektit, z. Astrit Halilaj, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit më datë 01.09.2022, kurse ankimi i subjektit rezultoi të jetë depozituar në Komision në datën 08.09.2022, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {***}, datë 08.09.2022, që rezultoi të jetë dita e 8-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Komisioni, me vendimin nr. {***}, datë 09.09.2022, ka vendosur të pranojë ankimin e datës 08.09.2022, si ankim të plotë dhe në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

⁶ Akte të depozituara nga subjekti i rivlerësimit bashkë me ankimin në Kolegji. 1. Kopje njësuar me origjinalin e vërtetimit nr. {***} prot., datë 23.11.2018, e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për vjetërsinë e shërbimit dhe pagën mesatare neto referuese, i administruar në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shëndetësore Tiranë (fletë nr.1). 2. Fotokopje e vërtetimit nr. {***} prot., datë 23.10.2016, e INSIG ShA, për vërtetimin e pagave të bashkëshortes, SH. H., kopje e këtij dokumenti është dorëzuar së bashku me deklaratën vetting. 3. Fotokopje e vërtetimit nr. {***} prot., datë 26.10.2016, e SHÇBA-së, për pagat e ish-punonjësit të këtij shërbimi, Astrit Halilaj, kopja e këtij dokumenti është dorëzuar së bashku me deklaratën vetting (fletë nr.1). 4. Kopje origjinale e statement bankar, lëshuar më datë 07.07.2022, nga ProCredit Bank, për mbajtësin e llogarisë Astrit Halilaj. 5. Kopje origjinale e statement bankar, lëshuar më datë 06.07.2022, nga Intesa Sanpaolo Bank, për mbajtësin e llogarisë, Astrit Halilaj. 6. Fotokopje të njësuar me origjinalin të urdhrave nr. {***}, datë 16.09.2009 dhe nr. {***}, datë 26.10.2009, të Ministrisë të Brendshme, për dërgimin me shërbim jashtë shtetit të drejtorit të SHKB-së, Astrit Halilaj, të shoqëruara me shkresën nr. {***} prot., datë 01.08.2022, të Drejtorisë së Arkivit në Ministrinë e Brendshme (gjithsej 7 fletë). 7. Deklaratë para noterit, bërë në Regensburg, Gjermani, më datë 04.05.2020, nga shtetasi S. P., së bashku me formularët e deklarimit të të ardhurave dhe listëpagesat për vitet 2003 – 2010. Këto dokumente janë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, me datë 06.07.2020, nga përkthyesja zyrtare R. P. (gjithsej 23 fletë). 8. Printim i email-it, të dërguar nga adresa e subjektit në adresë të Komisionit, më datë 22.06.2022, së bashku me dokumentet bashkëlidhur, për të provuar faktin e përcjelljes së provave të dërguara nga shtetasi gjerman S. P. (fletë nr. 1).

Ministrinë e Brendshme, ku përcillen urdhrat e Ministrit të vitit 2009, mbi shpenzimet e udhëtimeve jashtë shtetit. Nga analizimi i kësaj shkresë konstatohet se ajo është një kthim përgjigje e kërkesës së subjektit, së datës 07.07.2022, drejtuar këtij institucioni, disa ditë pas dhënies së vendimit; kopje origjinale e *statement* bankar, lëshuar më datë 07.07.2022, nga ProCredit Bank, dhe më datë 06.07.2022, nga Intesa Sanpaolo Bank, për mbajtësin e llogarisë Astrit Halilaj, përmbajnë të dhëna të viteve më parë, të cilat subjekti kishte mundësi t'i paraqiste gjatë hetimit administrativ. Ky konstatim vlen edhe për vërtetimin nr. {***} prot., datë 23.11.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për vjetërsinë e shërbimit dhe pagën mesatare neto referuese, të cilin subjekti pretendon se ka qenë i administruar në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shëndetësore, në dosjen e tij të pensionit dhe e ka marrë pas dhënies së vendimit të Komisionit, pas kthimit të përgjigjes negative nga Drejtoria e Policisë Tiranë, me argumentin se nuk janë gjetur borderotë e Komisariatit të Policisë nr. 2.

14. Një pjesë e akteve bashkëlidhur ankimit janë paraqitur edhe gjatë procesit të hetimit në Komision, sikurse është deklarata para noterit, datë 04.05.2020, nga shtetasi S. P., së bashku me formularët e deklarimit të të ardhurave dhe listëpagesat për vitet 2003 – 2010, fakt ky që vërtetohet nga printimi i *email*-it, të cilin subjekti ia ka bashkëlidhur ankimit. Ndërsa vërtetimi nr. {***} prot., datë 23.10.2016, i INSIG ShA, për vërtetimin e pagave të bashkëshortes, SH. H., dhe vërtetimi nr. {***} prot., datë 26.10.2016, i SHÇBA-së, për pagat e subjektit Astrit Halilaj, janë dorëzuar së bashku me deklaratën *vetting* dhe kanë qenë pjesë e dosjes së Komisionit.
15. Nga sa konstatuar më lart, bazuar në parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në kushtet që subjekti nuk ka dhënë arsye për të provuar se nuk ka qenë në gjendje t'i paraqiste këto akte në Komision, sjellja e tyre si provë e re në ankim, nuk përmbush testin e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, në të cilin parashikohet se: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohej prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se, pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.* Ky vlerësim i trupit gjykues të Kolegjit mban në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6⁷ e ligjit nr. 84/2016, për provat që duhet të refuzohen nëse nuk lejohen nga ligji. Në rastin konkret, në kushtet që subjekti nuk provon se mosparaqitja e provave në hetimin administrativ, në Komision, nuk është për faj të tij, trupi gjykues refuzoi marrjen e tyre në cilësinë e provës, sikurse parashikon neni 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.
16. Me parashtrimet e depozituara përpara seancës gjyqësore, më datë 05.05.2025, subjekti i rivlerësimit paraqiti akte⁸ shkresore të tjera, të cilat, po ashtu, kërkojnë të merren në cilësinë e provës. Lidhur me

⁷ Në nenin 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, parashikohet: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili, edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit.*

⁸ Aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit së bashku me parashtrimet, protokolluar në Kolegj nr. {***}, datë 05.05.2025. 1. Vërtetim datë 24.02.2021, së bashku me Inf. laboratorik, lëshuar nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Shkodër. 2. Informacion mjekësor, lëshuar nga Spitali Amerikan, më datë 28.04.2023, për pacientin A. H. 3. Raporte mjekësore, të lëshuara më datë 03.05.2023 dhe 17.12.2021, në Regensburg, Gjermani, nga Dr. R. B., të përkthyer dhe noterizuara me aktin noterial nr. {***} rep., datë 01.06.2023, së bashku me analizat. 4. Tri raporte për paafësi të përkohshme për punë, nr. {***}, datë 19.03.2021; nr. {***}, datë 07.05.2021 (fotokopje); dhe nr. {***}, datë 25.05.2021 (njësuar me origjinalin). 5. Raport i Ekzaminimit Radiologjik (rezonancë magnetike), datë 11.03.2021, Spitali Amerikan, pacienti Astrit Halilaj. 6. Vizita dhe analiza laboratorike në Spitalin Amerikan me datë 10.03.2021, si dhe disa receta mjekësore. 7. MRI koke (rezonancë magnetike) në qendrën "Medicare", datë 01.10.2021, pacienti Astrit Halilaj. 8. Urdhra të Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër, për përjashtimin nga shorti, datë 23.03.2021 dhe 21.06.2021. 9. Vendime të KLP-së, nr. {***}, datë 18.06.2021, së bashku me njoftimin në faqen zyrtare dhe nr. {***}, datë 17.12.2021. 10. Akt-

Eksptimi Kontabël, datë 20.02.2024, bërë nga Audituesi Ligjor, z. SH. M. 11. Akt-Eksptimi Vlerësues i banesës, bërë nga vlerësuesi Ing. N. G.J., datë 17.05.2023. 12. Vërtetim nr. {***} prot., datë 18.04.2023, lëshuar nga subjekti “{***}” ShPK, me NUIS-{***}, së bashku me ekstraktin e QKB-së. 13. Kontratë sipërmarrje me Ndërmarrjen Ndërtimore “{***}”, e vërtetuar para noterit më datë 24.06.1995, nr. {***} rep. dhe {***} kol.; Fotokopje e Lejes së Ndërtimit nr. {***} prot., datë 29.06.1995; Kërkesë për Leje Ndërtimi, datë 15.06.1995, formulari nr. {***}; Preventiv për objekt shtëpi banimi I-kat, bërë nga Ark. T. A.; Gent-Plani; Fotokopje e Planit të Themeleve dhe fotokopje e shkresës nr. {***} prot., 23.09.2005, e Drejtorisë së Urbanistikës, për dërgim dokumentacioni të konfirmuar ZVRPP Tirana I. 14. Fotokopje e vendimit nr. {***}, datë 28.02.1996, i Gjykatës së Rrethit Tiranë, vërtetim fakti juridik. 15. Përgjigje e ASHK-së, nr. {***} prot., datë 31.05.2023, së bashku me Lejen e Legalizimit, vetëdeklarimin dhe 4 fotografi me ngjyra, të banesës së Astrit Halilaj. 16. Përgjigje e ASHK-së, nr. {***} prot., datë 20.03.2023. 17. Deklaratë e datës 20.12.2023, bërë nga Ark. E. K., me vërtetim nënshkrimi para noterit, nr. {***} rep., datë 08.07.2024. 18. Pranim deklarate për kryerje punimesh, miratuar me shkresën nr. {***} prot., datë 30.09.2014, të Bashkisë Tiranë (fotokopje). 19. Akt-Vlerësimi mjeti motorik, bërë më datë 03.09.2024, nga Ing. A. J. 20. Përgjigje e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, nr. {***} prot., datë 27.08.2024. 21. Përgjigje e DPSHTRR-së, Tiranë, nr. {***} prot., datë 15.03.2023. 22. Përgjigje e DPT-së, nr. {***} prot., datë 25.05.2023. 23. Njoftim vlerësimi për detyrime tatimore DIVA 2011, tatimpaguesit Astrit Halilaj. Forumulari/D1 (DIVA), 11-A. Urdhër-Page, datë 01.10.2024 dhe njoftim debitimi datë 01.10.2024, Raiffeisen Bank, për pagesën 92.514 ALL. 24. Përgjigje e Ministrisë së Brendshme, nr. {***} prot., datë 21.03.2023. 25. Përgjigje e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, nr. {***} prot., datë 28.03.2023. 26. Urdhër-Shpenzimi, institucioni Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, nr. {***}, datë 12.11.2014, për pagesë reforme 2014, për Astrit Halilaj, shuma 408.400 lekë, sipas urdhrit nr. {***}, datë 11.11.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKB-së. 27. Vërtetim për vjetërsi shërbimi, nr. {***} prot., datë 23.11.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, model nr. {***}, për Astrit Halilaj (fotokopje). 28. Përgjigje e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, nr. {***} prot., datë 13.04.2023, së bashku me vërtetimin e të ardhurave 1997-2001, diferenca. 29. Vërtetim nr. {***} prot., datë 19.06.2023, lëshuar nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Buxhet - Financës. 30. Fotokopje e vendimit nr. {***}, datë 26.03.2002, i Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, i formës së prerë. 31. Përgjigje e AMP-së (Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore), nr. {***} prot., datë 11.05.2023. 32. Pjesë të vendimit nr. {***}, datë 08.10.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me shënimet për vendimet e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatën e Lartë, fotokopje. 33. Vërtetim nr. {***} prot., datë 27.07.2023, i Ministrisë së Brendshme, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, për të ardhurat e ish-punonjësit Astrit Halilaj, për vitet 2005 - 2009. 34. Vërtetim nr. {***} prot., datë 26.10.2016 (fotokopje), i SHÇBA-së (Shërbimi për Çështje të Brendshme dhe Ankesa), për të ardhurat e ish-punonjësit Astrit Halilaj, për periudhën 2010 - 2012. 35. Fotokopje e vërtetimit nr. {***} prot., datë 25.10.2016, lëshuar nga INSIG ShA, për të ardhurat e ish-punonjëses SH. H. 36. Vërtetim me nr. {***} prot., datë 17.05.2023, me nënshkrim elektronik, lëshuar nga Arkivi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore. 37. Dokumente të vërtetuara nga Drejtoria e Arkivit në Ministrinë e Brendshme, që lidhen me udhëtimet jashtë vendit të Astrit Halilaj. 38. Dokumente të njësuara nga AMP-ja (Agjencia e Mbikëqyrjes Policore), për shërbimet jashtë vendit të ish-drejtorit Astrit Halilaj. 39. Urdhër nr. {***}, datë 18.10.2013, i MBP-së (fotokopje), për pjesëmarrje në trajnim në SHBA. 40. Vërtetim nr. {***}, datë 10.04.2023, lëshuar nga kompania “{***}” ShPK, për shitjen e biletave dhe paketave turistike familjes Halilaj. 41. Deklaratë Noteriale nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 05.05.2023, e shtetasit gjerman S. P. 42. Dëshmi në gjuhën gjermane e lëshuar nga “{***}”, Regensburg, datë 27 korrik 2023, për z. S. P., e përkthyer dhe e vërtetuar nga noteri, me aktin nr. {***} rep., datë 31.08.2023 (vërtetim për të ardhurat vjetore nga puna). 43. Formular Regjistrimi (Certifikatë familjare) për familjen e S. P., lëshuar më datë 27.07.2023, nga Komuna Obertraubling, Regensburg, zyra për qytetarin, dhe e përkthyer në shqip, vërtetuar me aktin noterial nr. {***} kol., datë 31.08.2023. 44. Certifikata e martesës e S. P. dhe V. P. (Ç.), data e lidhjes së martesës 18.04.2006 dhe certifikata familjare me kryefamiljar H. Ç., lëshuar nga ZGJC, {***}, Bashkia Tropojë. 45. Raporte nga TIMS, për shtetasit S. dhe V. P. 46. Deklaratë Noteriale nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 12.06.2020, e shtetasit SH. J., së bashku me ekstraktin nga QKB për NUIS-{***}, dhe statement nga Raiffeisen Bank, në emrin e tij. 47. Deklaratë Noteriale e shtetasit F. Ç., nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 20.01.2025, së bashku me statementin bankar. 48. Certifikata Familjare dhe e martesës të Astrit Halilaj. 49. Përgjigje e DVKM-së, Shkodër, nr. {***} prot., datë 14.06.2022, së bashku me raportet e TIMS për shtetasit S. H. dhe F. H. 50. Përgjigje të INTERPOL - Tirana, me shkresat nr. {***} prot., datë 14.10.2024; nr. {***}, datë 05.11.2024; dhe nr. {***}, datë 15.11.2024, për shtetasit F. H. dhe S. H. 51. Vërtetimet e Gjendjes Gjyqësore për F.r H. dhe S. H. 52. Vërtetime të lëshuara nga DVP, Tiranë, punonjësit S. H. dhe F. H. 53. Certifikata për vërtetim pronësie, datë 20.04.2016 dhe 21.04.2016, të noterizuara, me nr. {***} rep., datë 20.01.2025, për pasuritë nr. {***}, pemëtore dhe {***}, truall + ndërtesë, ZK-{***}, F. Vogël, Tiranë, në emër të F. I. H. 54. Leje-Legalizimi, ALUIZNI, Tiranë 3, nr. {***}, datë 10.06.2015, për objektin Godinë banimi 2 kate+ kat nëntokë, Komuna {***}, Tiranë, në emër të F. H. 55. Kontratë Noteriale Dhurimi pasuri e paluajtshme, nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 13.06.2012, të 400 m² tokë, në {***}, Tiranë, dhuruesi Z. H. dhe pranuesi i dhurimit F. H. 56. Deklaratë Noteriale nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 11.07.2012, për heqjen dorë nga të drejtat reale të pronësisë për efekt legalizimi, për të vazhduar legalizimi i banesës në emër të F. H., së bashku me 4 fotografi me ngjyra të objektit, sipas vetëdeklarimit nr. {***}, datë 06.09.2006. 57. Deklaratë Noteriale nr. {***} rep. dhe {***} kol., Tiranë më 04.02.2025, e shtetasit A. XH. 58. Vërtetim {***} prot., datë 26.10.2016, lëshuar

pretendimin e subjektit të ngritur në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj para seancës gjyqësore, se si rezultat i disa problemeve shëndetësore gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, ka qenë e pamundur të realizohet një mbrojtje efektive në shkallën e parë të gjykimit, trupi gjykues konstaton se ky pretendim është ngritur prej tij për herë të parë vetëm në parashtrimet e sjella në Kolegj. Nga aktet e administruara nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë dorëzuar raport mjekësor në Komision për të treguar pamundësinë e tij, si dhe për të shpjeguar gradën e sëmundjes së tij apo t'i përcillte informacion të qartë dhe të detajuar për gjendjen shëndetësore. Subjekti, nëpërmjet email-it të datës 02.09.2021, drejtuar Komisionit, pa dhënë detaje për gjendjen e tij shëndetësore, thjesht ka bërë me dije se, *për shkak të disa problemeve me shëndetin, pas një periudhe prej dy muajsh raporte mjekësore, me vendimin nr. {***}, datë 18.06.2021, më është dhënë leje 6 muaj nga KLP-ja, duke filluar nga data 21.06.2021 deri më datë 20.12.2021*, si dhe i ka përcjellë Komisionit 2 (dy) vendimet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për miratimin e dhënies së lejes së papaguar”. Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë kërkuar kohë shtesë apo të ketë dhënë shpjegime për pamundësinë e tij shëndetësore për të realizuar mbrojtjen e tij në këtë proces. Gjithashtu, në kushtet kur ky pretendim i subjektit nuk është paraqitur as në ankimin e depozituar në Kolegj, trupi gjykues e vlerësoi atë se ka rënë në dekadencë dhe, për rrjedhojë, i përjashtoi aktet e depozituara me parashtrimet nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre provuese në zgjidhjen e çështjes, pasi vlerësoi se nuk plotësojnë kërkesat e nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49, pika 6, fjalía e parë e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin parashtrime me shkrim vetëm lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo prova të reja.

nga SHÇBA, fotokopje, së bashku me urdhër - shpenzimi nr. {***}, datë 12.11.2014, urdhër nr. {***}, datë 11.11.2014, për likuidim financiar; kthim përgjime e MBP-së nr. {***}, datë 28.08.2014, së bashku me kërkesën për pagesë për kompensim page, të njësuara me vule të njomë. **59.** Fotokopje të vërtetimit nr. {***} prot., datë 23.11.2018, e DPPSH-së, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe vërtetimit për pagën bazë të inspektorëve të krimeve pranë Komisariateve, sipas VKM-ve. **60.** Mandatet nr. {***}, datë 28.08.96 dhe nr. {***}, datë 09.09.96 në emër të F. I., të subjektit huamarrës “{***}”, të vërtetuar me origjinalin me aktin noterial nr. {***} rep., datë 29.01.2025, në Tiranë, së bashku me shkresën nr. {***} prot., datë 27.04.2023 të Shoqërive Huamarrëse në Administrim në Ministrinë e Financave dhe kërkesën e subjektit, e protokolluar me nr. {***}, datë 25.04.2023; **60.** Fotokopje e vendimit nr. {***}, datë 01.06.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe procesverbalit të datës 27.12.2013, të marrjes në dorëzim të dokumentacionit nga likuidatore e firmës piramidale “{***}”, në administrim. **61.** Deklaratë Noteriale nr. {***} rep. dhe {***} kol., Tiranë më 04.02.2025, bërë nga shtetasja M. Ç., eksperte kontabël, e caktuar si likuidatore në procedurat e falimentit të ish-firmës rentiere “{***}”. **62.** Deklaratë Noteriale nr. {***} rep. dhe {***} kol., Tiranë më 20.02.2025, e vëllait F. H., së bashku me disa fotografi të bëra në Gjermani, në vitin 2000 dhe disa dokumente të A. G., me të cilin ka jetuar në Shtutgart. **63.** Certifikatë lindje e F. H., me fotografi. **64.** Vërtetim i kryerjes së shërbimit ushtarak për F. H. **65.** Kopje origjinale të Mandatpagesave të datës 8.12.2001, për dyqanet nr. {***} dhe nr. {***}, Kulla Selita-{***}, “{***}”, klienti F. H., kontrata drita dhe ujë, me vulën e subjektit ndërtues, formularë tip, së bashku me fotokopjet e Akt-Mbarimit Kontrata dhe Faturë-Pagesë. **66.** Kopje të kontratave të qirasë nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 07.06.2002 dhe nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 27.12.2011, si dhe Zgjidhje Kontrate nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 17.01.2012, para noteres M. XH. **67.** Fotokopje e Kontratës së Qirasë nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 31.08.2015, para noterit A. B. **68.** Kontrata Noteriale Qiraje nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 11.11.2008; nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 15.02.2012; dhe nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 16.01.2015, para noteres M. XH. **69.** Fotokopje të dokumentacionit të depozitave në Fefad Bank dhe American Bank, së bashku me statementet përkatëse, si dhe mandatpagesat e tërheqjeve në Western Union, së bashku me përgjigjen e tyre nr. {***} prot., datë 15.11.2016. **70.** CD-R, me parashtrimet dhe fotografitë e banesës private të bëra në vitet 2006 dhe 2014, prova të tjera të skanuara dhe kopje të parashtrimeve. **71.** Tabelë me disa fotografi udhëtimesh zyrtare jashtë vendit, për të cilat mungojnë provat alternative, fotografi të ecursisë së ndërtimit të banesës private dhe viza në pasaportë. **72.** CV, e nxjerrë nga sistemi informatik RMIS i Policisë së Shtetit. **73.** Prova të tjera, fotokopje, që lidhen me integritetin dhe profesionalizmin, si: certifikata sigurie lëshuar nga DSIK-ja, referenca ndërkombëtare, kualifikime, dekreti i emërimit dhe statistika.

17. Pavarësisht nga ky vlerësim ligjor, trupi gjykues vëren se aktet e sjella me parashtrimet, subjekti ka pasur mundësinë t'i administronte dhe t'i paraqiste ato në Komision, kur edhe nga aktet në fashikull, nuk rezulton që subjekti të ketë kërkuar kohë shtesë për sigurimin e dokumentacionit gjatë hetimit administrativ. Lidhur me deklaratat noteriale të sjella prej subjektit, në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit⁹, megjithëse e vlefshme në kuptim të legjislacionit për noterinë, fuqia provuese e deklaratës noteriale, të hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, është e zbehtë. Në këtë rast, deklaratat në favor të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit janë hartuar pasi subjekti është njohur me vendimin e Komisionit për shkarkimin e tij nga detyra, fakt që nuk mund të mos ngrejë pyetje për mospërputhjen e pretendimeve me faktet, duke favorizuar situatën e subjektit.
18. Në të njëjtën linjë dhe duke abstraguar nga fakti që aktet e tjera paraqiten për herë të parë, trupi gjykues vëren se grupi i akteve të sjella me parashtrimet, për të provuar aspekte të ndryshme të pretendimeve të subjektit për vlerësimin e pasurisë, nuk kapërcejnë as kriteret e përcaktuara në nenin 49, pika 6, germet "a", "b" dhe "d" të ligjit nr. 84/2016, pasi marrja e tyre duket e panevojshme apo pretendojnë të provojnë fakte që, edhe nëse pranohen të vërteta, nuk ndikojnë në vendimmarrjen përfundimtare.

B. Vlerësimi lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit

19. Trupi gjykues, fillimisht, mori në shqyrtim kërkesën e subjektit të rivlerësimit në ankim, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, shqyrtimin dhe debatimin në themel të fakteve dhe provave. Për të evidentuar shkeljet procedurale që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, u analizuan shkaqet e ankimit me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, për të vlerësuar nëse është i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkeljeje të rëndë procedurale të Komisionit apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes.
20. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, jo vetëm që nuk ka marrë në konsideratë provat e paraqitura nga subjekti, për burimet e ligjshme të pasurisë së personave që Komisioni i ka konsideruar si persona të lidhur me subjektin, por dhe i ka mohuar atij të drejtën për t'i diskutuar këto prova në funksion të një mbrojtjeje efektive, duke cenuar dukshëm parimin e kontradiktoritetit në një proces të rregullt ligjor. Sipas subjektit, kjo mënyrë e të vepruarit të Komisionit është në kundërshtim të hapur me parimin për një gjykim të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe të pandikuar nga faktorë të tjerë. Gjithashtu, sipas subjektit, Komisioni nuk ka respektuar as procedurën e vlerësimit të provave të paraqitura sipas kërkesave të nenit 48 të Kodit të Procedurës Administrative. Komisioni, duke mos marrë në konsideratë provat e paraqitura që lidhen me burimin e ligjshëm të huas prej 10.000 eurosh, të marrë nga kunati F. Ç., ka cenuar parimin e barazisë së armëve, mbrojtjes efektive dhe të drejtën për një proces të rregullt dhe ligjor.

20.1. Në përgjigje të këtij shkaku ankimor, trupi gjykues sjell në vëmendje se procesi i rivlerësimit është një proces administrativ i iniciuar kryesisht. Referuar nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit hetojnë, vlerësojnë faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke kërkuar dhe administruar dokumentet për realizimin e hetimit administrativ. Vendimmarrja e Komisionit bazohet në këto dokumente dhe në provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me

⁹ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 6/2018 (JR), paragrafët 35 dhe 36; nr. 11/2019 (JR), paragrafi 27.12.1; nr. 34/2019 (JR), paragrafi 85.2; nr. 48/2022 (JR), paragrafi 31.

përgjigjet e pyetësorëve dhe me shpjegimet për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, në kuadër të barrës së provës, sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Të gjitha aktet shkresore administrohen në dosjen gjyqësore dhe trajtohen në harmoni me provat e tjera.

20.2. Nga shqyrtimi i akteve të administruara nga Komisioni, rezulton se subjektit të rivlerësimit i janë dhënë të gjitha mundësitë dhe garancitë për t'u mbrojtur. Subjekti ka pasur në dispozicion të gjithë kohën e nevojshme për t'u përgjigjur pyetjeve të pyetësorëve, duke i dhënë të drejtën të paraqesë shpjegime në lidhje me: (i) rezultatet e hetimit; (ii) kalimin e barrës së provës për të provuar të kundërtën e asaj çka ka rezultuar nga hetimi dhe (iii) vlerësimin e provave. Komisioni ka mbledhur dhe analizuar informacione nga institucionet qendrore dhe vendore, publike dhe private për subjektin e rivlerësimit, për të tria kriteret e rivlerësimit. Po ashtu, Komisioni ka pasur komunikim intensiv me subjektin e rivlerësimit për shkëmbim informacioni dhe ka administruar dokumentacionin provues të përcjellë prej tij. Kronologjia dhe përmbajtja e komunikimeve ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit dëshmon se subjekti i rivlerësimit është pyetur nëpërmjet pyetësorëve, duke dhënë përgjigjet përkatëse, ka përcjellë dokumente dhe akte në cilësinë e provave, ka dhënë shpjegime lidhur me to, nëpërmjet prapësimeve dërguar pas rezultateve të hetimit administrativ, i është dhënë e drejta të njohë aktet, ka parashtruar qëndrimin e tij mbi gjetjet e hetimit të Komisionit, është ftuar dhe ka marrë pjesë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit është njohur me dokumentacionin mbi të cilin është bazuar vendimmarrja e Komisionit dhe për këtë ka nënshkruar deklaratën e datës 13.06.2022, për njohjen me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike (CD) të dosjes së hetimit administrativ, duke konfirmuar se nuk ka asnjë vërejtje lidhur me të, fakt i konfirmuar prej tij edhe gjatë seancës dëgjimore. Nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka pasur kohën e mjaftueshme për të parashtruar shpjegimet mbi rezultatet e hetimit dhe për t'u përgjigjur pyetjeve të bëra në seancë nga relatori i çështjes.

20.3. Trupi gjykues konstaton se vendimi objekt shqyrtimi i Komisionit përmban analizën e akteve të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ. Rezulton se Komisioni ia ka nënshtruar vlerësimit të tij provat, duke marrë qëndrim mbi vlerën provuese të akteve të sjella prej subjektit të rivlerësimit. Analizimi dhe vlerësimi i tyre është kryer në përputhje me përcaktimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sa i përket vlerës provuese të tyre në raport me provat dhe aktet e tjera të administruara gjatë hetimit, si dhe për ndikimin e tyre në konkluzionet dhe në analizën financiare të kryer nga Komisioni. Po kështu, nuk rezulton që Komisioni të ketë përfshirë në vendim elemente, të cilat nuk i ka trajtuar gjatë hetimit administrativ dhe për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegimet e tij. Këto akte janë çmuar përkundër ndikimit që ato kanë mbi çështjet e ngritura, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative¹⁰.

20.4. Për sa i përket pretendimeve të subjektit, në lidhje me vlerësimin e akteve të depozituara në Komision në cilësinë e provës, trupi gjykues vlerëson se fakti që këto akte e prova të subjektit Komisioni nuk i ka vlerësuar në mënyrën e dëshiruar prej tij, nuk passjell logjikisht se ka munguar vlerësimi lidhur me to. Ky është edhe interpretimi i vlerësimit të provave zhvilluar nga jurisprudenca e GjEDNj-së, në drejtim të zbatimit në praktikë të garancive të procesit të rregullt ligjor, në çështjen *Wierzbicki k. Polonisë*, 2002¹¹. Provat në këtë proces janë çmuar në raport me njëra-tjetrën. Komisioni, për subjektin e rivlerësimit Astrit Halilaj ka ndjekur të njëjtën procedurë, si edhe për

¹⁰ “[...] Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrative”.

¹¹ Neni 6 i Konventës nuk garanton në mënyrë eksplicite të drejtën për të thirrur dëshmitarë apo për të paraqitur prova të tjera në gjykimet civile. Në lidhje me këtë, gjykata përsërit se vlerësimi i rëndësisë së provave për çështjet konkrete është kompetencë e gjykatave të brendshme.

subjektet e tjera të rivlerësimit, të përcaktuar nga neni 55 i ligjit nr. 84/2016 dhe akti rregullator i Komisionit, "Hapat proceduralë të unifikuar", referuar të cilëve vendimi përfundimtar merret pas bisedimeve përfundimtare me dyer të mbyllura të trupit gjykues, në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar, në përfundim të hetimit administrativ dhe zhvillimit të seancës dëgjimore. Vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk arriti një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë e çoi Komisionin në përfundimin se ndaj subjektit të rivlerësimit duhet aplikuar pika 3 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion është rezultat i interpretimit të trupit gjykues të dispozitave ligjore përkatëse në rrethanat e faktit dhe jo pasojë e moskonsiderimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej tij. Procesi i rivlerësimit është kryer sipas parashikimeve të akteve ligjore e rregullatore mbi bazën e të cilave Komisioni e zhvillon dhe e finalizon atë dhe trupi gjykues nuk konstaton asnjë qëndrim paragjykes të mbajtur nga Komisioni, dhe as ndonjë pretendim të ngritur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në këtë drejtim. Fakti që këto pretendime janë ngritur nga subjekti i rivlerësimit vetëm pas njohjes me vendimin përfundimtar të Komisionit, i bën këto pretendime të pabazuara.

21. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se Komisioni në konkluzionet e tij për kriterin e vlerësimit të pasurisë, përveç një vlerësimi të gabuar të provave dhe interpretimit të tyre në kundërshtim me përmbajtjen dhe parashikimet ligjore, ka cenuar parimin e objektivitetit, parimin e proporcionalitetit dhe parimin e sigurisë juridike, trupi gjykues thekson se, në përmbushje të qëllimit të procesit të rivlerësimit, që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi, për secilin prej kritereve të rivlerësimit, duhet të përjashtohet ekzistenca e rrethanave për të cilat parashikohet dhënia e masës disiplinore, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

21.1. Në kushtet kur për kriterin e pasurisë, Komisioni ka konkluduar se provat kanë nivelin e provueshmërisë dhe subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën për pjesën më të madhe të rezultateve të hetimit, pretendimi për vlerësim të parimit të objektivitetit vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar. Lidhur me kryerjen e analizës financiare për personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur, në funksion të vlerësimit të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues nuk gjen asnjë shkak për të cilin të pretendohet për tejkalim të objektit dhe qëllimit të procesit të rivlerësimit.

Në konsideratë të qëndrimit të Kolegjit,¹² trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se parimi i proporcionalitetit është një pjesë e tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqet procesi i rivlerësimit dhe nuk mund të gjejë zbatim si parim i veçantë dhe i vetëm i rivlerësimit, dhe Komisioni është i autorizuar të peshojë dhe të balancojë interesat e përfshira deri në atë masë që ligji nr. 84/2016 jep hapësirë për opsione të ndryshme, por nuk është i autorizuar t'i vlerësojë disa prej tyre më ndryshe se të tjerat, pa ndonjë arsye objektive. Për pasuritë nën hetim administrativ, trupi gjykues konstaton se konkluzionet e Komisionit referojnë lidhur me saktësinë e deklarimeve të subjektit për mjaftueshmërinë financiare për krijimin e pasurive, të deklaruara prej tij. Komisioni, nga vlerësimi për kriterin e kontrollit të pasurisë, mbështetur në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ka dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se, sipas përfundimeve të arritura, masa disiplinore është proporcionale.

¹² Shih vendimet e Kolegjit nr. 2/2020 (JR), datë 27.02.2020; nr. 20/2020 (JR), datë 08.09.2020 dhe nr. 36/2020 (JR), datë 16.12.2020.

22. Subjekti i rivlerësimit, duke iu referuar 4 (katër) kriterëve të përcaktuara në vendimin e GjEDNj-së në çështjen *Volkov v Ukrainë*, për përcaktimin e organit që vendos masa disiplinore, pretendon se Komisioni ka cenuar nenin 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për sa i përket formimit të trupit gjykues pa garancitë e nevojshme për pavarësi dhe paanshmëri. Sipas subjektit, trupi gjykues që ka kryer hetimin dhe gjykimin e tij, nuk ka asnjë gjyqtar në përbërjen e tij. Anëtarët e Komisionit janë emëruar nga Kuvendi i Shqipërisë në një proces të mirëfilltë politik, duke caktuar në këtë detyrë persona të njohur për lidhjet e ngushta politike. Anëtarët e Komisionit që kanë dhënë vendimin, janë të njëjtët që kanë kryer hetimin administrativ ndaj tij, duke cenuar në këtë mënyrë, sipas subjektit, parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme.

22.1. Lidhur me këtë grup pretendimesh të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se ato lidhen me funksionimin dhe organizimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, dhe jo me veprime apo mosveprime konkrete të Komisionit që lidhen me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit individualisht. Në shqyrtimin e këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit mbajmë në konsideratë faktin që Komisioni është ngritur nga Kushtetuta si një organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili do të kryejë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas një procedure, e cila garanton respektimin e parimeve të procesit të rregullt dhe të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit.¹³

22.1/a. Kriteret e zgjedhjes në detyrë të Komisionerëve janë përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, ku referuar parashikimeve të nenit 6, pika 1, germa “ë” e ligjit, bie në sy fakti se qenia gjyqtar apo prokuror gjatë dy viteve të fundit para kandidimit, përcaktohet si kriter përjashtues në vlerësimin e kandidaturave për t’u zgjedhur Komisionerë. Për më tepër vlen të theksohet fakti që ligji nr. 84/2016 i është nënshtruar kontrollit mbi kushtetutshmërinë e tij edhe nga Gjykata Kushtetuese,¹⁴ e cila gjatë kontrollit të ushtruar prej saj në kuadër të vlerësimit të përputhshmërisë së parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën, nuk ka konstatuar asnjë problematikë në drejtim të përbërjes së Komisionit, me efekt cenimin e parimit të pavarësisë dhe të paansësisë.

22.1/b. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues çmon të theksojmë natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit, që, në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t’i nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton çdo hap në detaj që do të duhet t’i paraprinte emërimit fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t’i lihej rastësisë, do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin.

¹³ Shih nenin 179/b, pikat 2, 5, 6, 8 dhe 10 të Kushtetutës.

¹⁴ Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, ka arsyetuar: Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Gjykata ka theksuar se, me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Garancia e kohëzgjatjes dhe e paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet [...].

22.1/c. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, referuar dhe jurisprudencës së tij¹⁵, trupi gjykues çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Si rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për mospërmbushje të kushteve të zgjedhshmërisë për anëtarët që kanë gjykuar çështjen e tij në Komision, nuk gjendet i bazuar.

22.1/ç. Po kështu, nga analiza e komunikimeve elektronike dhe shkëmbimeve të informacioneve në rrugë shkresore mes subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit dhe nga konsultimi me procesverbalin e seancës dëgjimore, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë parashtruar pretendime për shkelje të të drejtave të garantuara në ligj për procesin e rregullt ndaj tij, gjatë rivlerësimit në Komision, apo të ketë parashtruar kërkesa specifike, të cilat të jenë rrëzuar nga trupi gjykues e që tregojnë apo mund të pretendojnë njëanshmëri ose mosprespektim të parimeve për një proces të rregullt ligjor gjatë hetimit.

22.1/d. Në vazhdim të analizës së këtij shkaku ankimi, konstatohet se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit, si pasojë e mungesës në përbërje të tij të anëtarëve të cilët vijnë nga sistemi gjyqësor, është trajtuar nga GjEDNJ-ja, në vendimin e saj, lidhur me çështjen gjyqësore Xhoxhaj kundër Shqipërisë¹⁶. GjEDNJ-ja ka arritur në konkluzionin se nuk gjen evidencë të mungesës së pavarësisë së Komisionit, si pasojë e mospasjes në përbërje të tij të anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke mos konstatuar, për rrjedhojë, shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së lidhur me sa më sipër. Sa më sipër i qëndron edhe testit teorik të zhvilluar nga jurisprudenca e GjEDNJ-së në dy çështjet e sipërcituara – Astraðsson dhe Cani, nën dritën e nenit 13 të KEDNJ-së për zgjidhjen efektive.

22.1/dh. Në kushtet kur kërkimet e subjektit të rivlerësimit, në tërësinë e tyre, do të gjejnë trajtim në analizën e detajuar dhe të pavarur që do të kryhet nga trupi gjykues i Kolegjit, nga një gjykatë e krijuar me ligj, vlerësohet se të gjitha çështjet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit, në kontekstin e të drejtave procedurale edhe zgjidhjes në themel, shtjelluar në vijim, i janë nënshtruar kontrollit gjyqësor dhe plotësojnë kriteret e një procesi, që në tërësinë e tij është i rregullt.

23. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka cenuar parimin e shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, lidhur me respektimin e nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për barrën e provës. Sipas subjektit, barra e provës i kalon atij, vetëm kur ai kërkon të provojë se dokumentet dhe provat e siguruara nga Komisioni nuk pasqyrojnë vërtetësi për sa i përket tre komponentëve të rivlerësimit, por sipas subjektit nuk ka rezultuar asnjë provë që të ketë arritur nivel provueshmërie që ndaj tij të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

¹⁵ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 43/2022 (JR), datë 15.11.2022; nr. 3/2023 (JR), datë 06.02.2023.

¹⁶ GjEDNJ-ja, ndër të tjera, ka arsyetuar: “[...] Për sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, Gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih Oleksandr Volkov). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit, që kishte pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tri kriterëve dhe ka për qëllim rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është “sui generis” dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin. Ajo vëren se këto anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj. Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë [...]”.

23.1. Trupi gjykues vëren se, referuar parashikimit të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal, Komisioni, me kalimin e barrës së provës subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjetjet e rezultuara nga procesi i hetimit administrativ, nuk ka cenuar të drejtën e subjektit për t'u mbrojtur, por përkundrazi ka zbatuar me përpikëri procedurën e rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit kushtetues dhe atij ligjor. Pavarësisht këtij konstatimi, trupi gjykues sqaron se këto pretendime të subjektit të rivlerësimit do të analizohen më poshtë në këtë relacion, së bashku me shkaqet e ankimit me natyrë materiale, që lidhen me analizimin e problematikave të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

24. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka mbajtur qëndrime të ndryshme në çështje të ngjashme, duke konfirmuar në detyrë subjektet e tjera, megjithëse kanë pasur shuma monetare të pajustificuara nga të ardhurat nga emigracioni, trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë shqyrtimi i ankimit të subjektit do të kryhet në Kolegj, duke u referuar në aktet e çështjes që i përkasin asaj të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, është e panevojshme dhe e paarsyeshme të kryhen kontrole apo referime mbi elemente të caktuara të vlerësimit të pasurisë, që Komisioni ka bërë në një vendim tjetër të tij. Për pasojë, ky pretendim i subjektit mbetet i pamundur për t'u verifikuar e vlerësuar dhe, gjithsesi, nuk e pengon Kolegjin të bëjë një vlerësim të pavarur të shkaqeve të ankimit objekt shqyrtimi, pavarësisht qëndrimeve që ka mbajtur Komisioni në raste të tjera, të cilat janë të pavlerësuara prej Kolegjit.

24.1. Lidhur me sa më lart, trupi gjykues vlerëson se një pretendim i tillë i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak procedural për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat lidhen me vlerësimin e kriterëve të rivlerësimit, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi, dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar në praktikën e tij gjyqësore¹⁷.

25. Në përmbyllje të ankimit të tij, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se, për sa kohë nuk është identifikuar asnjë shkelje në të tria kriteret e vlerësimit gjatë kohës së ushtrimit të profesionit të prokurorit, ndërsa shkeljet e pretenduara nga Komisioni i përkasin një periudhe të largët, gati dy dekada më parë, ka kërkuar që të aplikohet parimi i proporcionalitetit dhe i objektivitetit në vlerësimin e kriterit të pasurisë, duke referuar në vendimin e Kolegjit nr. 6/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit H. K.

25.1. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të këtij shkak ankimi, mori në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit për të çmuar në rastin objekt shqyrtimi, nëse është me vend që të gjejë zbatim parimi i proporcionalitetit dhe i objektivitetit në raport me mungesën e burimeve të ligjshme të konstatuara nga Komisioni dhe arsyeton si vijon.

25.2. Referuar nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, rivlerësimi i subjekteve për kriterin e kontrollit të pasurive kryhet nga organet e rivlerësimit, në përputhje me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016. Në kuptim të dispozitës së sipërcituar kushtetuese dhe Kreut IV të ligjit nr. 84/2016, çdo pasuri, sipas kuptimit të dhënë në nenin 3, pika 11 e ligjit të rivlerësimit, që është objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*, i nënshtrohet

¹⁷ Shih vendimin e Kolegjit nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019.

kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklaramit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues. Në referim të kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, konstatohet se në asnjë prej dispozitave të këtij korpusi ligjor nuk parashikohet ndonjë normë juridike, sipas së cilës të vendosen kritere vlerësimi, lidhur me pasuritë e subjekteve dhe personave të lidhur, me qëllim përfshirjen apo përjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe Kreut IV të ligjit nr. 84/2016.

25.3. Gjithashtu, në një interpretim të dispozitave të zbatueshme lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurive, sipas qëllimit të procesit të rivlerësimit kalimtar, të përcaktuar në nenin 179/b, pika 1 e Kushtetutës¹⁸ dhe në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit¹⁹, apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Konfirmimi i një marrëdhënieje të tillë të magjistratit në raport me ligjin, qoftë në formën e veprimeve të tij në kundërshtim me ligjin, apo edhe në formën e pranimin të veprimeve të personave të lidhur me të, cenon vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit/rolit në dhënien e drejtësisë.

25.4. Për më tepër, nga interpretimi sistematik i dispozitave të ligjeve të paketës për reformën në drejtësi, trupi gjykues arrin në konkluzionin se standardi i vendosur në kuadër të kësaj reforme, në lidhje me verifikimin e pasurive të trupës së magjistratëve, kërkon kontrollin e plotë të pasurive të deklaruara, qofshin këto të krijuara para apo pas emërimit në detyrë të magjistratit, për sa kohë, referuar dispozitave të ligjit për statusin e magjistratit, verifikimit të plotë të pasurive, sipas të njëjtave standarde të përcaktuara nga legjislacioni i posaçëm për kontrollin dhe deklarimin e tyre, i nënshtrohen edhe kandidatët për t'u pranuar në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës,²⁰ si dhe të diplomuarit prej kësaj shkolle para emërimit të tyre si magjistratë gjyqtarë/prokurorë²¹.

25.5. Trupi gjykues në vijim të analizës së mësipërme çmon të theksojë se, pavarësisht faktit që subjekti i rivlerësimit është emëruar në detyrën e prokurorit në muajin prill të vitit 2016, procesit të kontrollit i nënshtrohen të gjitha pasuritë e deklaruara nga subjekti në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë *vetting*, përfshirë ato të krijuara para emërimit si prokuror, për më tepër kur subjekti i rivlerësimit, që prej vitit 2003, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9049/2003, ka qenë subjekt deklarues në ILDKPKI dhe pasuritë e krijuara gjatë kësaj periudhe janë objekt rivlerësimi. Pretendimin e subjektit

¹⁸ Neni 179/b, pika 1 parashikon: "1. Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi".

¹⁹ Shih vendimin e Kolegjit nr. 3, datë 26.01.2021, paragrafi 71.

²⁰ Neni 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", parashikojnë: "1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31 të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës. [...] 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete, ose ka dhënë një deklaratë të rreme, ose jo të saktë të aseteve [...]".

²¹ Neni 35, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" parashikon: "1. I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere: [...] c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji".

se ai i ka krijuar këto pasuri para marrjes së detyrës, trupi gjykues nuk e vlerëson se i shërben në mënyrë domethënëse situatës konkrete edhe për shkak të faktit se, ndonëse jo në detyrën e prokurorit, subjekti ka kryer funksionet e Oficerit të Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë së Tatimeve, si dhe të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme, gjatë gjithë kohës së krijimit të këtyre pasurive.

25.6. Z. Astrit Halilaj ka filluar detyrën e prokurorit më datë 22.04.2016 dhe para kësaj date ka qenë subjekt i deklarimit sipas ligjit nr. 9049/2003, i cili rregullon deklarimin e pasurisë dhe interesave privatë për një gamë më të gjerë funksionarësh publikë, përfshirë edhe gjyqtarët dhe prokurorët, ligj i cili ka një qëllim më të përgjithshëm dhe të vazhdueshëm. Ndërsa ligji nr. 84/2016 ka një mekanizëm më të thelluar të kontrollit, ku Komisioni dhe Kolegji analizojnë jo vetëm pasuritë e subjekteve të rivlerësimit, por kontrollojnë edhe anën profesionale dhe të figurës të tyre. Të dyja ligjet trajtojnë aspektin e kontrollit të pasurisë, por me qasje të ndryshme.

25.7. Ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 5, parashikon se deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga organet e rivlerësimit. Këto deklaratat, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë për verifikimin dhe vlerësimin e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit materializohet në kontrollin e saktësisë dhe të mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit në deklaratën e rivlerësimit, krahasuar me deklaratimet periodike, ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të (pasuri e paluajtshme/e luajtshme/likuiditete).

25.8. Në vijim të analizës dhe interpretimit të dispozitave ligjore si më sipër, në kushtet kur z. Astrit Halilaj rezulton se ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive së tij dhe të personave të lidhur me të, në kohën që ka ushtruar funksione të larta drejtuese shtetërore, mund të ndikojë si element tregues në mënyrën e perceptimit të publikut të sistemi i drejtësisë, për sa kohë nuk mund të përjashtohet edhe mundësia e fitimit/përdorimit të pasurive në shkelje të ligjit, jashtë periudhës së ushtrimit të detyrës.

26. Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrolloi vendimin e Komisionit, zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke mos e kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së mësipërme lidhur me kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e akteve të reja në cilësinë e provës, në kuadër të kerkimit të tij në ankim për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe hetimit administrativ, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

27. Lidhur me pasurinë “banesë private 2 kate dhe kat nënçati”, të ndodhur në rrugën “{*}”, Tiranë**

27.1. Komisioni, për këtë pasuri vlerësoi se subjekti nuk arriti të japë shpjegime bindëse për të përmbysur barrën e provës dhe të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që janë përdorur për ndërtimin e godinës së banimit trekatëshe. Sipas Komisionit, subjekti e mbart këtë detyrim pavarësisht se pasuria në analizë është krijuar përpara fillimit të detyrës, për sa kohë ka qenë ndër pasuritë e deklaruara prej tij dhe, kështu, është objekt vlerësimi e verifikimi të burimit të ligjshëm, në kuadër të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, bazuar në parashikimet e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë ka një mungesë të konsiderueshme të burimeve të ligjshme financiare në masën totale prej 4.729.542 lekësh.

27.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se analiza financiare, vlerësimi dhe çmuarja e provave dhe konkluzionet e arritura nga Komisioni për këtë pasuri janë tërësisht të gabuara dhe në kundërshtim me frymën e ligjit nr. 84/2016. Komisioni duhej të merrte në konsideratë vetëm blerjen e lëndës së parë, pasi objekti është ndërtuar nga ai vetë me ndihmën e familjarëve (vëllezërve). Sipas subjektit, shpenzimet faktike për ndërtimin e këtij objekti janë shumë më pak se vlera prej 5.000.000 lekësh, e deklaruar prej tij në deklaratën *vetting*, të shpërndara ndër vite nga 1995 deri në 2014.

27.2/a. Subjekti pretendon se Komisioni ka arritur në një konkluzion të gabuar edhe në lidhje me kohën e përfundimit të katit të dytë dhe katit të tretë, duke e konsideruar të përfunduar objektin në vitin 2002, pasi sipas tij objekti në atë kohë ka qenë në fazën e karabinasë dhe sipas standardeve të ndërtimit, shpenzimet për punimet në fazën e karabinasë zënë rreth 40% të shpenzimeve totale të ndërtimit të objektit. Sipas subjektit, shpërndarja e investimit për ndërtimin e këtij objekti duhet të bëhej deri në vitin 2014.

27.2/b. Lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e objektit, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që të merret në konsideratë edhe fakti se gjatë viteve 1995 – 1997, në vendin tonë, ka ekzistuar fenomeni i huadhënies në firmat piramidale, ku ai, si shumë persona të tjerë, ka gjeneruar të ardhura nga kjo veprimtari gjatë 2 (dy) viteve.

27.3. Në kushtet kur subjekti në ankim ka ngritur pretendimin lidhur me kohën e ndërtimit të banesës trekatëshe dhe investimin e kryer ndër vite për secilin kat, trupi gjykues fillimisht mori në analizë deklaratimet e tij në deklaratat e interesave pasurorë periodikë (në vijim “DIPP”), shpjegimet e dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ në Komision, si edhe aktet e administruara për këtë qëllim.

27.3/a. Lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën e interesave periodikë vjetorë, si më poshtë:

- i. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Banesë private 2 kate + kat nën çati, rr. “{***}”, nr. {***}, Njësia nr. {***}, me sipërfaqe trualli 420 m², e ndërtuar vetë në vitin 1997 (leje ndërtimi e vitit 1995). Nr. Pasurie {***}, ZK {***}, ZRPP Tiranë. Vlera 5.000.000 (pesë milionë) lekë shpenzime përafërsisht. Pjesa 50%”*. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e ligjshëm për investimin në ndërtimin e saj.

- ii. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2016, subjekti ka kryer të njëjtin deklaram lidhur me këtë pasuri.
- iii. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë prej subjektit të rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2003,²² si një banesë private (1+2), me sipërfaqe 120 m² dhe me përshkrimin: *“e ndërtuar vetë në vitin 1994”*, me vlerë 2 milionë lekë. Subjekti ka deklaruar pjesën takuese prej 1/4 e saj.
- iv. Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar në rubrikën e ndryshimeve të interesave privatë: *“investim në ndërtim papafingo në banesën ekzistuese, karabina nën çati”*, me vlerë 300.000 lekë, pa specifikuar burimin e krijimit të shumës për ndërtimin e saj.
- v. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar kryerjen e një pagese prej 185.000 lekë për legalizim (oborr dhe shtesë kati), të paguar me lekë dhe me letra me vlerë, përkatësisht 1.700.000 lekë dhe letra me vlerë nominale 400.000 lekë, të blera këto në tregun e lirë me 15.000 lekë.
- vi. Në DIPP-në të vitit 2012, subjekti ka deklaruar shtesë banese ekzistuese (katesh) dhe oborr (420 m²) me leje legalizimi nr. {***}, datë 22.12.2011, me anë të kontratës me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.06.2011, regjistruar në ZRPP Tiranë në datën 19.1.2012. Subjekti ka deklaruar se ka paguar në total 185.000 lekë, nga të cilat 170.000 lekë dhe 4.000.000 lekë në letra me vlerë, të blera këto në tregun e lirë me 15.000 lekë, me burim nga të ardhurat personale.

27.3/b. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit është shprehur se nuk disponon ndonjë dokument që të provojë shpenzimet e kryera për këtë investim, por ka bërë me dije se kostoja e ndërtimit është rreth 5.000.000 lekë, duke shpjeguar se fillimisht është ndërtuar një banesë njëkatëshe me sip. 120 m² me vlerë rreth 2.000.000 lekë, punimet e së cilës kanë nisur që në vitin 1995 dhe është përfunduar në vitin 1999, më pas, ndër vite, janë ndërtuar kati i dytë dhe papafingoja me sipërfaqe të njëjtë.

27.3/c. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, të dërguar nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se kati i parë është ndërtuar gjatë vitit 1995 dhe është bërë i banueshëm në vitin 1997, kur është ndërtuar dhe kati i dytë në fazë karabina, më pas, në vitin 2006, kur ai ka aplikuar për legalizimin e banesës, ajo ishte e përfunduar si karabina, por kati i tretë ka qenë i papërfunduar ende nga brenda. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti i rivlerësimit është shprehur se në vitin 1997 kishte përfunduar karabinaja e katit të dytë dhe të tretë, si dhe çatia, por i banueshëm ka qenë vetëm kati i parë.

27.3/ç. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ka shpjeguar se godina e banimit është ndërtuar një kat sipas lejes së ndërtimit në vitin 1995, ndërsa në vitin 1997 kishte mbaruar si karabina së bashku me çatinë, ndërkohë që pothuajse ishte përfunduar vetëm kati i parë dhe se kati i dytë dhe papafingoja kanë qenë përfunduar deri në vitin 2005, ndërsa në vitin 2014 është përfunduar kati nën çati. Ai ka shpjeguar se në formularin e legalizimit të vitit 2006, banesa ka qenë e përfunduar në dy kate dhe se kjo dallohet nga fotografitë që papafingoja është e papërfunduar.

27.3/d. Gjatë seancës dëgjimore në Komision, subjekti ka shpjeguar se përfundimi i punimeve është kryer në vitin 2014 dhe ka kërkuar që kostot e ndërtimit të rishpërndahen deri në vitin 2014, por pa e specifikuar konkretisht sasinë dhe kohën se në cilat vite ishte kryer shpenzimi i pretenduar i shpërndarë si investim gradual ndër vite.

²² Në vitin 2003, z. Astrit Halilaj ka deklaruar si Oficer i Policisë Gjyqësore në Sektorin e Policisë pranë Degës së Tatimeve Tiranë, ndërsa në vitin 2009 ka deklaruar si Drejtor i Përgjithshëm i SHKB-së pranë Ministrisë së Brendshme, deri në datën 16.10.2013, kur edhe rezulton të jetë larguar nga ky funksion publik. Në prill të vitit 2016 është dekretuar si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

27.3/dh. Sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka dhënë informacion të qartë në lidhje me përcaktimin e periudhave konkrete të ndërtimit apo përfundimit të godinës dhe kateve të kësaj banese, si edhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kohës për të provuar koston reale apo të përafërt të ndërtimit të këtij objekti dhe shpenzimet përkatëse për secilin vit.

27.4. Nga analizimi i dokumentacionit të ndodhur në dosje rezulton se: Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) Tirana Jug²³ i ka përcjellë Komisionit dokumentacionin, ku rezulton se për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit është pajisur me leje legalizimi nr. {***}, datë 22.12.2011, për objektin “godinë banimi 3 kate”, të ndodhura në Z. K. {***}, me sipërfaqe ndërtimore 420 m², sipërfaqe ndërtimi 139.8 m² dhe sipërfaqe totale ndërtimi 413.56 m², në bazë të së cilës është regjistruar në datën 20.01.2012, pasuria “godinë banimi 3 kate” me nr. {***}, të ndodhur në rrugën “{***}”, në Z. K. {***}, në emër të z. Astrit Halilaj. Gjithashtu, në dosje gjendet, ndër të tjera, dokumentacioni si më poshtë:

(i) Kontratë sipërmarrje e datës 24.06.1995, ku ndërmarrja private “{***}” ka marrë përsipër që t’i ndërtojë z. Astrit Halilaj një shtëpi banimi njëkatëshe, por pa specifikuar vlerën e ndërtimit.

(ii) Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. {***} vendimi, nr. {***} akti, datë 28.02.1996, sipas së cilës është vendosur pranimi i kërkesës së kërkuarit, z. Astrit Halilaj, për vërtetimin e faktit juridik të ndërtimit të një shtëpie dykatëshe në fshatin {***}, vendim ky që ka marrë formë të prerë në datën 13.03.1996.

(iii) Vërtetimi i pronësisë i ZRPP-së Tiranë, datë 26.06.1997, sipas së cilës në pronësi të SH. H. dhe Astrit Halilaj është regjistruar pasuria shtëpi dykatëshe, e ndodhur në Selitë të Vogël. Regjistrimi i kësaj prone është bërë me anë të kontratës së dhurimit²⁴ dhe vendimit të sipërcituar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

27.5. Me qëllim identifikimin e periudhës së ndërtimit të katit të parë dhe të dytë të këtij objekti, trupi gjykues, duke iu referuar dokumentacionit të disponuar, siç është vendimi datë 28.02.1996, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “për vërtetimin e faktit juridik mbi ekzistencën e një godine dykatëshe”, konstaton se në përmbajtjen e tij citohet, ndër të tjera, se në katin e parë ndodhej një kuzhinë, dy dhoma, korridor dhe banjë dhe në katin e dytë ndodhej një kuzhinë, dy dhoma, korridor dhe banjë, me konstruksion mur tulle, e mbuluar me soletë monolite dhe çati. Nga të dhënat që përmban vendimi gjyqësor i vitit 1996, konstatohet se, së paku në këtë vit, ndërtimi i katit të dytë nuk ka qenë në fazë karabina, për sa kohë duket se kanë qenë të përfunduara edhe ndarjet e mureve të brendshme të katit të dytë, duke u identifikuar edhe në funksionin e tyre të shfrytëzimit, si kuzhinë, dhomë etj. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për konsiderimin të përfunduar të katit të parë dhe katit të dytë të këtij objekti deri në shkurt të vitit 1996.

27.5/a. Në lidhje me kostot e ndërtimit të katit të parë, referuar dokumentit “Akt - Kolaudimi”, i datës 05.09.2005, me objekt “Godinë banimi 1 kat”, përgatitur nga ing. B. M., i bashkëlidhur me praktikën e ASHK-së, ku citohet se: “Në bazë të situacioneve të shlyera nga investitori rezulton se vlera faktike e punimeve të kryera në këtë objekt është 1.200.000 lekë”, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin

²³ Me shkresat nr. {***} prot., datë 15.08.2017; nr. {***} prot., datë 22.11.2018; nr. {***} prot., datë 06.04.2020 dhe nr. {***} prot., datë 10.11.2021.

²⁴ Nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.06.1997, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e dhuruesit, ka deklaruar se në këtë banesë bën bashkëpronare me 1/2 bashkëshorten e tij, znj. SH. H. Në dosje gjendet deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.11.2011, e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, SH. H., e cila ka deklaruar se shpenzimet për ndërtimin e pronës së ndodhur në Tiranë, në {***}, janë përballuar vetëm nga subjekti dhe ajo nuk ka kontribuar në ndërtimin e saj.

e Komisionit, për të konsideruar si vlerë financiare të investimit shumën prej 1.200.000 lekësh, bazuar në një dokument të kohës.

27.5/b. Lidhur me koston e ndërtimit të katit të dytë, trupi gjykues, nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kohës për të provuar koston reale apo të përafërt të këtij objekti, e vlerëson të drejtë referimin e Komisionit në vlerat e EKB-së, konkretisht sipas vendimit nr. 815, datë 09.12.1996, *“Për miratimin e vlefshëm mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë dhe të vlefshëm të koeficientit ‘k’, sipas të cilit kostoja mesatare e ndërtimit në vitin 1995, në qytetin e Tiranës, ka qenë 12.883 lekë/m² ndërtimi. Kjo shumë, e ndarë në mënyrë proporcionale në bazë të muajve, duke konsideruar fillimin e punimeve pas marrjes së lejes së ndërtimit, në qershor 1995 e deri në shkurt 1996, duke zbritur vlerat për fondin rezervë dhe fitimin e planifikuar²⁵, kostoja e ndërtimit të katit të dytë rezulton në vlerën (143.98 m² x 12.883 lekë/m²) – (8.14 % x 1.854.895 lekë) = 1.691.107 lekë. Totali i kostonë së ndërtimit për dy katet e para është në shumën 2.891.107 lekë.*

27.5/c. Bazuar në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 4, se deri në vitin 1997 ishte përfunduar edhe kati i tretë, por në fazë karabina, si dhe çatia, trupi gjykues vlerëson se Komisioni, me të drejtë, ka përfshirë në analizë edhe ndërtimin në fazë karabina të këtij kati, duke konsideruar shpenzimin e kryer në vitin 1997. Referuar marrëveshjes së datës 17.05.2006, të lidhur midis Ministrisë së Financave dhe Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë, *“Për përcaktimin e treguesve minimalë për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim”,* në tabelën nr. 3 të saj, ndër të tjera, përcaktohet volumni që zënë zërat e punimeve, si vijon: (i) struktura beton-arme zë 36.4% të volumnit të punimeve dhe (ii) vendosje hekur betoni zë 7.7% të volumnit të punimeve, në total 44.1% të volumnit të punimeve. Si rrjedhojë, Komisioni, me të drejtë, ka përllogaritur shpenzimin e kryer në vitin 1997, duke zbritur vlerat për fondin rezervë dhe fitimin e planifikuar, sipas së cilës rezulton se kostoja e ndërtimit të katit të tretë është në vlerën (139.8 m² x 16.567 lekë/m² x 44.1%) – (8.83 % x 1.021.385 lekë) = 931.197 lekë, si shpenzim i vitit 1997.

27.5/ç. Për të provuar se përfundimi i punimeve të ndërtimit të kësaj banese është kryer në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjithashtu në Komision kërkesën nr. {***} prot., datë 30.09.2014, të depozituar në Bashkinë e Tiranës, me objekt *“Për kryerje punimesh, riparime, lyerje fasade dhe riparim të shkallëve në objektin ekzistues tre kate”,* si dhe katër fotografi të objektit. Trupi gjykues vlerëson se ky dokument, i paraqitur nga subjekti, nuk vërteton faktin se objekti ka qenë i papërfunduar, për sa kohë subjekti është pajisur me leje legalizimi nr. {***}, datë 22.12.2011, për objektin *“godinë banimi 3 kate”,* me sipërfaqe ndërtimore 420 m², në bazë të së cilës është regjistruar në datën 20.01.2012, pasuria *“godinë banimi 3 kate”,* e ndodhur në rrugën *“{***}”*. Ndërsa fotografitë e objektit nuk mundësojnë identifikimin e periudhës përkatëse kohore, ndonëse nga përshkrimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit, në email-in e datës 28.06.2022, përmendet viti 2014, si vit i realizimit të fotografive të banesës, me sy të lirë dallohet përfundimi i objektit, por vetëm dritaret e katit të tretë nuk janë të vendosura. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit, duke e konsideruar si të përfunduar tërësisht në gusht të vitit 2006, referuar formularit të vetëdeklarimit, datë 07.09.2006, për legalizimin e objektit *“shtëpi banimi trekatëshe”*.

²⁵ Duke iu referuar jurisprudencës së fundit të Kolegjit dhe konkretisht vendimeve nr. 6/2022 (JR), datë 17.03.2022 dhe nr. 7/2022 (JR), datë 29.03.2022, lidhur me koston e llogaritura të ndërtimit. E barabartë me 8.83% për periudhën 1996 – 1997 dhe për periudhën 1998 – 2006, Komisioni ka përllogaritur një mesatare prej ~ 9.14%.

Nga sa më lart, duke prezumuar një kosto mesatare të ndërtimit të vitit 1998²⁶ dhe vitit 2006²⁷, përkatësisht 22.647 lekë/m² ndërtimi, duke zbritur vlerat për fondin rezervë dhe fitimin e planifikuar, janë kryer shpenzime në masën $(139.8 \text{ m}^2 \times 22.647 \text{ lekë/m}^2 \times 55.9\%) - (9.14\% \times 1.769.822 \text{ lekë}) = 1.608.060 \text{ lekë}$, për përfundimin e këtij kati. Kjo vlerë, me të drejtë, nga Komisioni është shpërndarë në analizën financiare në mënyrë të barabartë mes viteve, përkatësisht prej 145.340 lekë në vit, për periudhën 1998 – 2006. Kostoja totale e ndërtimit të katit të tretë, pas vitit 1997, është 1.608.060 lekë.

27.5/d. Referuar pretendimit të subjektit të rivlerësimit, *mbi rishpërndarjen e kostove në kohë për ndërtimin e kësaj banese, deri në fund të vitit 2014*, trupi gjykues i rezulton se ky pretendim i tij gjen hapësirë vetëm në rishpërndarjen e kostove të përfundimit të ndërtimit të katit të tretë. Nëse do të pranohej pretendimi i shtrirjes në një periudhë më të gjatë kohore të përfundimit të katit të tretë deri në vitin 2014 – nisur nga rritja e koston së ndërtimit me kalimin e viteve – kjo ripërlllogaritje do të çonte në një efekt të kundërt, me shtimin e kostove për këtë kat në shumën 2.785.551 lekë, duke e rritur kështu koston totale të ndërtimit të kësaj banese në krahasim me atë të përlllogaritur më lart, nga 5.430.364 lekë në 5.676.658 lekë. Por, edhe nëse do të konsiderohej ky pretendim i subjektit për shtrirjen e këtyre punimeve deri në vitin 2014, duke i ripërlllogaritur shpenzimet përkatëse në harkun kohor deri në vitin 2014, sërish subjekti do të rezultonte me një pamjaftueshmëri financiare të ngjashme dhe të konsiderueshme, në masën 4.696.617 lekë, duke mos ndikuar kështu në rezultatin final.

27.5/dh. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se Komisioni duhej të merrte në konsideratë vetëm blerjen e lëndës së parë, sepse objekti është ndërtuar nga ai vetë me ndihmën e familjarëve (vëllezërve), pasi sipas tij objekti në atë kohë ka qenë në fazën e karabinasë dhe sipas standardeve të ndërtimit, shpenzimet për punimet në fazën e karabinasë zënë rreth 40% të shpenzimeve totale të ndërtimit, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka paraqitur dokumente ligjore provuese të kohës, të tilla si: transferta nga familjarët (vëllezërit) për ndihmë financiare; deklarata noteriale të kohës nga vëllezërit për të provuar se kanë marrë pjesë në ndërtimin e banesës; fatura, preventivë apo situacione për blerjen e lëndës së parë, për ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë. Në këto kushte, në mungesë të dokumentacionit ligjor provues të subjektit për të mbështetur pretendimet e tij, ato mbeten në nivel deklarativ dhe të pabazuara.

27.5/e. Nga sa më lart, në kushtet kur subjekti, si gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu edhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, nuk e ka specifikuar konkretisht sasinë dhe kohën se në cilat vite ishte kryer shpenzimi i shpërndarë i pretenduar si investim gradual ndër vite, trupi gjykues e vlerëson të drejtë përlllogaritjen e kryer nga Komisioni për vitet e ndërtimit të kësaj banese. Gjithashtu, për sa kohë subjekti nuk ka paraqitur ndonjë akt tjetër provues, si preventiv/situacion punimesh, fatura apo çdo lloj dokument tjetër për investimin në banesën trekatëshe, me sipërfaqe totale ndërtimi 413.56 m², trupi gjykues, duke iu referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit,²⁸ e vlerëson të drejtë referimin e Komisionit në udhëzimet për çmimet referuese të koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive ndër vite, duke konsideruar se çmimet e tyre paraqesin vlera minimaliste të koston së ndërtimit.

²⁶ Vendim nr. 214, datë 28.04.1999, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banësive nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banësive dhe të koeficientit ‘k’, sipas të cilit kostoja mesatare e ndërtimit në vitin 1998, në qytetin e Tiranës, ka qenë 20.033 lekë/m² ndërtimi.

²⁷ Udhëzim nr. 5, datë 07.09.2006, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banësive, nga Enti Kombëtar i Banësive, dhe të koeficientit ‘k’ për vitin 2006”, sipas të cilit kostoja mesatare e ndërtimit në vitin 2006, në qytetin e Tiranës, ka qenë 25.262 lekë/m² ndërtimi.

²⁸ Vendimet e Kolegjit nr. 6/2022 (JR), datë 17.03.2022 dhe nr. 7/2022 (JR), datë 29.03.2022.

27.6. Lidhur me pretendimin e subjektit, se në analizën e tij financiare duhet të merret në konsideratë edhe fakti se, *në kushtet kur gjatë viteve 1995 – 1997, në vendin tonë ka ekzistuar fenomeni i huadhënies në firmat piramidale, ne, si shumë persona të tjerë, kemi gjeneruar të ardhura nga kjo veprimtari gjatë 2 (dy) viteve*, trupi gjykues konstaton se subjekti, jo vetëm që për herë të parë e ka ngritur këtë pretendim në ankimin e paraqitur në Kolegj, por nuk paraqiti dokument justifikues ligjor në mbështetje të tij gjatë hetimit administrativ në Komision. Ndërsa dokumentacioni²⁹ i paraqitur së bashku me parashtrimet në mbështetje të këtij pretendimi, megjithëse u vlerësua se nuk plotëson kërkesat e nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, sipas të cilave, deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin parashtrime me shkrim vetëm lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo prova të reja, nga një vështrim *prima facie* i tyre rezulton se ato pasqyrojnë të dhëna për shuma të përfituara nga vëllai i tij F. (I.) H., për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit mbeti në nivel deklarativ dhe i pambështetur në prova.

27.7. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për të përballuar investimet e kryera për ndërtimin e banesës dhe arredimin e saj, si edhe shpenzimet e jetesës, kontrolloi analizën financiare për periudhën 1994 – 2006, në përfundim të së cilës i rezultoi se, për ndërtimin e pasurisë objekt kontrolli dhe përballimin e shpenzimeve të tjera të familjes, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, të paktën aq sa konstatuar prej Komisionit, në vlerën prej - 4.729.542 lekësh, gjatë periudhës 1994 – 2006.

27.8. Në përfundim, për pasurinë “banesë private 2 kate dhe kat nënçati”, të ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave që janë përdorur për ndërtimin e godinës së banimit trekatëshe, për rrjedhojë, subjekti ka një mungesë të konsiderueshme të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e saj, duke u gjendur në situatën faktike që kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

28. Lidhur me pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 79 m²” dhe “vendparkim”, në Vlorë

28.1. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, ka bërë deklarament të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, bazuar në parashikimet e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni nuk e përfshiu në analizën financiare shumën prej 10.000 eurosh, hua e marrë prej kunatit të subjektit, për sa kohë nuk është provuar burimi i ligjshëm i huadhënësit, si dhe nuk ka përlllogaritur në këtë analizë shumën prej 4.252 USD, që rrjedh nga kursimet e vëllezërve të subjektit, në masën 27.000 USD, të depozituara në llogarinë e tij, pjesë e të cilave kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë në qytetin e Vlorës.

28.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim provat e paraqitura prej tij lidhur me burimin e ligjshëm të huas prej 10.000 eurosh, dhënë nga kunati, F. Ç., e cila ka shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie, konkretisht deklaratën noteriale të shtetasit gjerman S.

²⁹ Mandatet nr. {***}, datë 28.08.96 dhe nr. {***}, datë 09.09.96, në emër të F. I., të subjektit huamarrës “{***}”, të vërtetuar me origjinalin me aktin noterial nr. {***} rep., datë 29.01.2025, në Tiranë, së bashku me shkresën nr. {***} prot., datë 27.04.2023, të Shoqërive Huamarrëse në Administrim në Ministrinë e Financave dhe kërkesën e subjektit, e protokolluar me nr. {***}, datë 25.04.2023; Fotokopje e vendimit nr. {***}, datë 01.06.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe procesverbalit të datës 27.12.2013, të marrjes në dorëzim të dokumentacionit nga likuidatore e firmës piramidale “{***}”, në administrim. 61. Deklaratë noteriale nr. {***} rep. dhe {***} kol., Tiranë, më 04.02.2025, bërë nga shtetasja M. Ç., eksperte kontabël, e caktuar si likuidatore në procedurat e falimentit në ish-firmën rentiere “{***}”.

P. Sipas subjektit, Komisioni duhej ta përfshinte në analizën financiare vlerën e huas prej 10.000 eurosh, për pagesën e kështit të parë të blerjes së apartamentit në Vlorë, pasi vjen nga një burim i ligjshëm, duke e konsideruar shtetasin S. P. si person tjetër të lidhur.

28.2/a. Subjekti pretendon se shuma prej 4.252 USD, e paguar në favor të firmës ndërtuese për të plotësuar kështin e parë prej 20.000 eurosh, për prenotimin e apartamentit në Vlorë, është tërhequr nga depozita në ProCredit Bank dhe vërtetohet me *statementin* e bankës, datë 07.07.2022. Subjekti pretendon se, ashtu sikurse ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, depozitat me vlerë 27.000 USD janë krijuar me remitancat nga puna në emigracion e vëllezërve të tij, duke e vërtetuar këtë fakt nga të dhënat e sistemit TIMS dhe disa mandate të Western Union, dërguar në adresë të subjektit nga punëdhënësit, ku kanë punuar vëllezërit e tij. Subjekti i rivlerësimit kërkon që këto fonde të përfituara nga puna në emigracion e vëllezërve dhe të depozituara në bankë, duhet të përfshihen në analizën financiare dhe të konsiderohen se kanë burim të ligjshëm. Subjekti referon në vendimin nr. 479, datë 03.12.2021, të Komisionit dhe vendimin nr. 15/2019, datë 17.07.2019, të Kolegjit. Sipas subjektit, përfshirja e këtyre fondeve në analizën e tij, do të përmbyste balancën negative në lidhje me krijimin e kështit të parë prej 20.000 eurosh, që janë përdorur për prenotimin e apartamentit në Vlorë.

28.2/b. Subjekti pretendon se Komisioni, në mënyrë të padrejtë, nuk i ka përfshirë në analizën financiare për vitin 2010 të ardhurat nga paga e tij dhe të bashkëshortes, pasi, referuar dokumentacionit³⁰ të dorëzuar së bashku me deklaratën *vetting*, të ardhurat në total nga paga përbëjnë shumën 2.579.211 lekë. Nga diferenca rezulton se nuk janë pasqyruar në tabelën e analizës financiare nr. {***}, të Komisionit, shuma prej 1.635.303 lekësh. Subjekti kërkon nga Kolegji që të bëjë një përllogaritje të saktë, mbështetur në provat e administruara në lidhje me mundësinë financiare faktike të tij, për blerjen e apartamentit në Vlorë.

28.3. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të shkaqeve të mësipërme të ankimit, analizoi dokumentacionin e ndodhur në fashikujt e Komisionit lidhur me këtë pasuri dhe i rezultoi se:

28.3/a. Apartamenti me sipërfaqe 79 m,² ndodhur në Vlorë, është deklaruar për herë të parë nga subjekti në DIPP-në e vitit 2010,³¹ si i përfutur me anë të kontratës së premtim-shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.08.2010, me vlerë totale 35.000 euro, nga të cilat janë paguar dy kështet e para në shumën 20.000 euro. Burimi i të ardhurave është deklaruar nga: (i) të ardhurat vjetore; (ii) depozitë bankare pranë ProCredit Bank; dhe (iii) hua në shumën 10.000 euro, sipas kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.08.2010.

28.3/b. Në deklaratën e interesave pasurorë periodikë të vitit 2011, subjekti ka deklaruar: *pagesë kështi në vlerën 8.000 euro, për blerjen e apartamentit sipas kontratës noteriale nr. {***}, datë 14.08.2010.* Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: *pagesë 5.000 euro, për shlyerje të kontratës së blerjes së apartamentit, datë 14.08.2010,* në deklaratën pas largimit nga funksioni, në vitin 2013, subjekti nuk ka deklaruar ndonjë pagesë apo ndonjë detyrim të mbetur të pashlyer për këtë apartament.

28.3/c. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë “apartament”, me vlerë 35.000 euro, si dhe, për herë të parë, edhe pasurinë e llojit “garazh i hapur” ose vendparkim, me vlerë 5.000 euro, me burim krijimi nga kursimet e familjes. Subjekti nuk ka deklaruar huan e marrë nga shtetasi

³⁰ Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 26.10.2016, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave, të ardhurat e subjektit nga paga për vitin 2010 janë 1.605.625 lekë, ndërsa sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 25.10.2016, të INSIG ShA, të ardhurat neto nga paga e bashkëshortes, SH. H., për vitin 2010 janë 973.586 lekë.

³¹ Në vitin 2010, subjekti ka deklaruar nga pozicioni si Drejtor i SHKB-së në Ministrinë e Brendshme.

F. Ç., si një ndër burimet e krijimit të pasurive në fjalë. Ndërsa, të njëjtin deklaramin subjekti e ka bërë në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2016³².

28.3/ç. Bashkëngjitur deklaratës *vetting*, subjekti ka dorëzuar kontratën e premtim-shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 14.08.2010, lidhur ndërmjet palës shitëse së ardhme “{***}” ShPK dhe palës blerëse së ardhme, z. Astrit Halilaj, sipas së cilës palët kanë rënë dakord për blerjen e një apartamenti, 1+1, në katin e pestë, me sipërfaqe totale 79 m², përfshirë edhe ambientet e përbashkëta prej 11 m², kundrejt çmimit prej 35.000 euro.

i. Referuar përmbajtjes së kontratës së sipërcituar, palët kishin rënë dakord se shuma prej 35.000 eurosh do të likuidohej si vijon:

- a) 10.000 euro pas nënshkrimit të kontratës;
- b) 10.000 euro brenda datës 30.12.2010;
- c) 10.000 euro në momentin e dorëzimit të apartamentit me punime të përfunduara;
- d) 5.000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes.

ii. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjithashtu deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.10.2016, të lëshuar nga administratori i shoqërisë shitëse “{***}” ShPK, z. DH. P., i cili ka deklaruar se pasuria e llojit “apartament” është shlyer plotësisht nga subjekti, në fund të vitit 2014. Po ashtu ka bërë me dije se, në muajin gusht të vitit 2014, z. Astrit Halilaj ka blerë edhe një vendparkim, me vlerë 5.000 euro, shumë kjo e likuiduar *cash* në momentin e blerjes.

28.4. Lidhur me analizën financiare të burimeve³³ të krijimit të pasurisë “apartament”, megjithëse subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie vetëm kursimet e familjes, në kushtet kur në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2010, subjekti ka deklaruar si burime krijimi për këtë pasuri të ardhurat vjetore, huan nga kunati F. Ç. dhe depozitën bankare në ProCredit Bank, trupi gjykues, pasi mori në analizë këto burime krijimi të deklaruar, si dhe pretendimet e subjektit në ankim, konstaton dhe vlerëson si vijon:

28.4/a. Hua nga shtetasi F. Ç.

i. Lidhur me këtë hua, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, kontratën e huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 13.8.2010, të nënshkruar mes tij dhe huadhënësit, z. F. Ç., për marrjen hua të një shume të hollash prej 10.000 eurosh, me afat shlyerje 5-vjeçar, përkatësisht nga 2.000 euro në vit. Bashkëlidhur gjenden lëvizje të një llogarie bankare³⁴ nga Raiffeisen Bank, të shtetasit F. Ç., në të cilën janë pasqyruar veprimet e periudhës dhjetor 2009 deri në shkurt 2011.

³² Në vitet 2014 dhe 2015, subjekti nuk ka qenë subjekt deklarimi.

³³ Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, është shprehur se: “Kësti i parë, 20.000 euro, është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kontratës, me burim nga të ardhurat vjetore, depozitë bankare dhe vlera prej 10.000 euro, marrë hua kunatit F. Ç., sipas kontratës së datës 13.8.2010, 1 (një) ditë para se të nënshkruhej kontrata për blerjen e apartamentit. Burimi i krijimit të shumës 8.000 eurosh, në vitin 2010, janë të ardhurat personale nga paga e ime dhe e bashkëshortes. Të gjitha pagesat janë bërë në *cash*”. Gjithashtu ka sqaruar se: “...të gjitha detyrimet për blerjen e apartamentit dhe garazhit janë shlyer në vitin 2014, përshkruar edhe në deklaratën noteriale të vitit 2016, dhe pas kësaj periudhe nuk kam pasur më detyrime për të shlyer”.

³⁴ Nga këto lëvizje kanë rezultuar dy depozitime parash, përkatësisht prej 29.103 euro, në datën 08.12.2009, me përshkrimin “kalim në llogari extra” dhe 19.800 euro, në datën 30.04.2010, me përshkrimin “të ardhura nga biznesi”. Po ashtu janë evidentuar disa tërheqje parash, kryesisht gjatë periudhës mars – prill 2010, si dhe një dërgesë prej 17.000 euro, në datën 04.05.2010, në favor të një shtetasi tjetër.

ii. Nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, në deklaratat e interesave pasurorë periodikë rezulton se, në DIPP e vitit 2010, e ka deklaruar kontratën e huas, madje ka deklaruar edhe qëllimin e marrjes së saj (për likuidimin e kështit të parë të apartamentit 1+1, në Vlorë), gjithashtu, rezulton se subjekti ka deklaruar shlyerjet e huas në fjalë, si në vijim:

- a) 2.000 euro të likuiduar sipas DIPP-së së vitit 2011;
- b) 2.000 euro të likuiduar sipas DIPP-së së vitit 2012;
- c) 2.000 euro të likuiduar sipas deklaratës pas largimit nga funksioni, në vitin 2013.

iii. Lidhur me mënyrën e krijimit të të ardhurave të kunatit të tij, F. Ç., subjekti pretendon se ai i ka përfutur këto të ardhura nga kunati i tij S. P., çka e vërteton nëpërmjet deklaratës datë 04.05.2020, të bërë para noterit në Gjermani dhe e përkthyer në gjuhën shqipe, sipas së cilës shtetasi S. P. deklaron se i ka dhënë në posedim kunatit të tij, F. Ç., shumën prej 30.000 eurosh për prenotimin e një apartamenti në Shëngjin, e duke qenë se ka hequr dorë nga ky investim, pas kërkesës së F., ka rënë dakord që shumën prej 10.000 eurosh t'ia jepte hua subjektit, për blerjen e apartamentit në Vlorë. Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion për të provuar të ardhurat nga puna në Gjermani e shtetasit S. P.

28.4/b. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, që shtetasi S. P. të konsiderohet person tjetër i lidhur, pasi është ai që i ka dhënë shumën e parave shtetasit F. Ç., trupi gjykues vëren se huan subjekti i rivlerësimit e ka marrë nga shtetasi F. Ç., nëpërmjet kontratës së huas të datës 13.08.2010. Referuar përcaktimit të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, *“Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi, dhe përcaktimit të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*. Nga kontrata e huas, në cilësinë e huadhënësit identifikohet vetëm shtetasi F. Ç., dhe nuk rezulton nga dokumentacioni apo nga deklaratimet e subjektit, ndonjë lidhje interesi e subjektit me shtetasin S. P., e për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen këtë pretendim të subjektit të pabazuar.

28.4/c. Deklarata e datës 04.05.2020, e shtetasit S. P., e hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, jo vetëm që ka një vlerë të kufizuar provuese, por nuk vërteton mënyrën e kalimit të shumave të parave nga ky shtetas në drejtim të huadhënësit F. Ç. dhe aq më pak dhënien e shumës hua subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, nga kontrolli i lëvizjeve të llogarisë bankare të shtetasit F. Ç., për periudhën 2009 – 2010, nuk vërtetohet se të ardhurat e transferuara/depozituara në llogarinë e tij, janë dërguar nga shtetasi S. P. Konkretisht, gjatë kësaj periudhe, kjo llogari është kredituar nëpërmjet transfertës së datës 08.12.2009, me vlerën 29.103 euro dhe me përshkrimin “kalim në llogari extra”, si edhe nëpërmjet depozitimit *cash* nga F. Ç., në datën 30.04.2010, në vlerën 19.800 euro dhe me përshkrimin “të ardhura nga biznesi”. Nga një kërkim i kryer në faqen web të QKB-së, nuk ka rezultuar ndonjë aktivitet tregtar i regjistruar në emër të shtetasit F. Ç., së paku në vitet 2009 – 2010. Gjithashtu rezulton se nga kjo llogari janë kryer disa tërheqje *cash* gjatë periudhës mars – maj 2010, në total 31.803 euro, si edhe është kryer një transfertë prej 17.000 eurosh, në datën 04.05.2010, në favor të një shtetasi³⁵ tjetër. Në kushtet kur subjekti nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor mbi të ardhurat e huadhënësit F. Ç. dhe paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, vetëm pas njohjes me rezultatet e hetimit, e bën deklarin/qëndrimin e subjektit mbi burimin e kësaj huaje kontradiktor dhe jo bindës, e për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit mbetet në nivel deklarativ.

³⁵ Transfertë me përfutues shtetasin SH. J., me përshkrimin “Kalim në llogari”.

28.4/ç. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të argumenteve të tij për ligjshmërinë e të ardhurave të personave të lidhur, pretendon se koncepti i ligjshmërisë së pasurisë lidhet me burimin e krijimit dhe jo me pagimin e detyrimeve tatimore. Subjekti, duke iu referuar legjislacionit mbi të ardhurat, pretendon se një e ardhur nuk klasifikohet në sistemin financiar si e paligjshme, nëse mbi të nuk janë paguar taksat. Ky pretendim i subjektit është i pabazuar në ligj, pasi neni D i Aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar konceptin se kush do të konsiderohen pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji, konkretisht të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

28.4/d. Trupi gjykues, në përgjigje të shkakut ankimor të subjektit të rivlerësimit, çmon të theksojë se neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 e ngarkon subjektin e rivlerësimit dhe personin tjetër të lidhur që, në kuadër të marrëdhënies së huas së konfirmuar, të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua dhe kthimit të saj nga huamarrësi. Ky nen është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit³⁶, duke mbajtur në konsideratë edhe kufijtë proporcionalë të kontrollit pasuror për personat e tjerë të lidhur dhe raportin përpjesëtimor, që duhet të ketë ky kontroll me barrën e provës të subjektit të rivlerësimit, në justifikimin e pasurisë objekt huaje.

28.4/dh. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar huan në shumën prej 10.000 eurosh, në deklaratën e pasurisë *vetting*, si burim krijimi për pasurinë “apartament”, në Vlorë. Subjekti nuk ka deklaruar/specifikuar në ndonjë prej deklaratave të tij periodike marrjen e huas me burim nga të ardhurat e shtetasit S. P. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit, që shumën prej 10.000 eurosh të mos e konsiderojë si një nga burimet shumës 20.000 euro, në vitin 2010, për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, për sa kohë nuk është provuar burimi i ligjshëm i huadhënësit, duke mos e përfshirë në këtë mënyrë si të ardhur në analizën financiare të vitit 2010.

28.5. Lidhur me depozitën bankare në ProCredit Bank, nga e cila është tërhequr shuma 4.252 USD / 3.200 euro, në vitin 2010, për blerjen e pasurisë objekt kontrolli, trupit gjykues, nga analizimi i dokumentacionit, i rezultoi se:

28.5/a. Kjo depozitë është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003, në shumën 10.000 USD, me burim nga emigracioni. Në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar edhe një depozitë në Bankën Amerikane (sot “Intesa Sanpaolo Bank”), në shumën 17.000 USD. Sipas subjektit, *këto depozita janë të vëllezërve, S. dhe F. H., emigrantë në Angli, të dërguara cash dhe me Western Union (për të cilat disponoj fatura), dhe se, në mungesë të tyre në Shqipëri, depozitat figurojnë në emrin tim.*

28.5/b. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur se: *“Shuma 27.000 USD kanë qenë para të dërguara nga vëllezërit në emigracion, në Gjermani dhe me pas në Angli, të cilët kanë punuar për disa vite në emigracion. Ata kanë punuar në sektorin e ndërtimit dhe paratë i kanë dërguar kryesisht me Western Union, por edhe në cash, me persona të besuar, më pas këto para janë depozituar në bankë dhe më pas janë përdorur sipas nevojave për familjen dhe prindërit. Këto depozita kanë qenë të mbyllura, përpara se unë të filloja detyrën si prokuror për herë të parë, në prill 2016. Nga ana ime është kërkuar informacion pranë Western Union, por për shkak të kohës së gjatë, prej rreth 20 vitesh, nuk është ruajtur dokumentacioni, pasi Western Union ruan dokumentacionin vetëm për një afat 5-vjeçar, bazuar në Ligjin për Bankat. Deklaroj, nën përgjegjësinë time, se vëllezërit e mi kanë kryer gjithmonë punë të ndershme dhe nuk kanë asnjë rekord kriminal në asnjë*

³⁶ Shih vendimet nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019, nr. 20/2019 (JR), datë 31.07.2019 dhe nr. 2/2023 (JR), datë 02.02.2023, të Kolegjit.

shtet. Subjekti ka sqaruar se paratë u janë dorëzuar vëllezërve sipas kontributit të tyre dhe një pjesë është përdorur për pagesën e këstit të parë të apartamentit në Vlorë.

28.5/c. Me shpjegimet e rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka depozituar në Komision disa mandate tërheqjeje³⁷ parash nga Western Union, të dërguara në favor të subjektit, nga Belgjika dhe Mbretëria e Bashkuar, nga disa shtetas të tjerë, jo vëllezërit e tij, dhe raportet e hyrje-daljeve nga sistemi TIMS, për shtetasit F. dhe S. H. Gjithashtu, subjekti ka depozituar në Komision deklaratën noteriale të datës 17.06.2022 të vëllait të tij, F. H., i cili ka deklaruar se ka emigruar nga viti 1999 në Gjermani dhe nga viti 2005 e më pas, në Britaninë e Madhe dhe se, nga puna e ligjshme gjatë këtyre viteve, ka fituar të ardhura rreth 60.000 USD, të cilat i ka dërguar nëpërmjet personave të ndryshëm, por edhe me Western Union. Në këtë deklaratë, vëllai i subjektit, F. H., ka deklaruar se shuma prej 32.000 USD është investuar për blerjen e dyqaneve në Kullat Hawai, ndërsa pjesa tjetër, shuma prej 27.000 USD, është depozituar nga vëllai i tij, Astrit Halilaj, në bankë të nivelit të dytë. Subjekti ka paraqitur gjithashtu vërtetim, datë 15.11.2016, nga Unioni Financiar Tiranë, sipas të cilit të dhënat personale të klientëve mbahen për një periudhë 5-vjeçare dhe më pas fshihen.

28.5/ç. Trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon lëvizjet e llogarisë në ProCredit Bank, nga e cila rezulton se shuma prej 10.000 USD është depozituar *cash* nga subjekti në datën 08.07.2003, në llogarinë e kursimit me nr. {***}, në të njëjtën datë, e gjithë shuma është kaluar në llogarinë e depozitës me nr. {***} dhe ka qëndruar e investuar në depozitë me afat deri në datën 17.11.2006, datë në të cilën është transferuar në llogarinë rrjedhëse me nr. {***}. Nga kjo llogari, në të njëjtën datë, është tërhequr *cash* shuma 6.482 USD (nga ku 482 USD janë interesat e përfituara ndër vite). Shuma e mbetur prej 4.000 USD është transferuar në llogarinë e depozitës me nr. {***} dhe ka vijuar të qëndrojë në depozitë me afat, deri në datën 07.12.2010, datë në të cilën është tërhequr *cash* shuma 4.252 USD (nga ku 252 USD janë interesat e përfituara ndër vite).

28.5/d. Lidhur me mandatet e Western Union, të paraqitura prej subjektit të rivlerësimit me qëllim vërtetimin e faktit se shumatat e depozituara në bankë kanë si origjinë të ardhurat e vëllezërve të tij, trupi gjykues konstaton se të gjitha transfertat e pretenduara të vëllezërve të subjektit, në periudhën 2001 – 2003, nuk kanë si dërgues asnjërin prej vëllezërve të tij, por figurojnë persona të tjerë si dërgues të transfertave, me përfitues subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se ka mospërputhje të periudhave të emigrimit me vendet respektive të deklaruara, krahasuar me mandatet e sipërcituara, pasi rezulton se një transfertë është dërguar nga Brukseli, ndërsa 5 të tjerat janë dërguar nga Londra, në një kohë që, referuar deklaratës noteriale të vëllait të subjektit, F. H., ai ka deklaruar se deri në periudhën 1999 – 2005 ka qenë emigrant në Gjermani, e më pas në Angli. Ndërsa lidhur me të ardhurat e vëllait tjetër të subjektit të rivlerësimit, z. S. H., përveç raportit të sistemit TIMS, i cili vërteton se ky shtetas ka qenë jashtë shtetit në periudha dhe afate të ndryshme, nuk rezulton ndonjë dokument tjetër, që të vërtetojë se ka qenë i punësuar në mënyrë të rregullt dhe ka përfituar të ardhura të ligjshme nga puna.

³⁷ Gjashtë mandate të tërheqjes së parave nga Western Union, në shumatat: 500 DM, me datë 27.09.2001; 1200 paund, me datë 18.09.2001; 800 paund, me datë 15.11.2001; 200 paund, me datë 06.11.2002; 400 paund, me datë 11.05.2002; dhe 500 paund, me datë 28.03.2003, për të cilat subjekti pretendon se këto shuma janë dërguar nga punëdhënësit ku kanë punuar vëllezërit e tij.

Trupi gjykues, në konkluzion të sa më sipër, konstaton se mund të provohet fakti se vëllezërit e subjektit të rivlerësimit kanë jetuar jashtë shtetit, por nuk është e mundur të provohet me dokumentacion ligjor të kohës dhënia apo kthimi i shumave të pretenduara të fituara në emigracion.

28.5/dh. Për sa i takon burimit të ligjshëm të të ardhurave të vëllezërve të subjektit, që kanë mundësuar krijimin e kursimeve në masën 27.000 USD, të depozituara në llogarinë e subjektit, pjesë e të cilave kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë në analizë, trupi gjykues konstaton se asnjë prej këtyre mandateve nuk rezulton të ketë si dërgues vëllezërit e subjektit të rivlerësimit në rubrikën e dërguesit/ve. Gjithashtu, nuk ka rezultuar e provuar me dokumentacion ligjor dërgimi i shumave nga vendi i origjinës prej vëllezërve të subjektit dhe burimi i ligjshëm i krijimit të tyre. Nga analiza e lëvizjeve të llogarisë bankare, nuk vërtetohet lidhja e fondeve të depozituara nga subjekti, me vëllezërit e tij, për më tepër, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar ndonjë prokurë të kohës, për të provuar përfaqësimin apo autorizimin e vëllezërve të tij për hapjen e depozitave në emër të tyre. Për sa i përket akteve të paraqitura nga subjekti bashkëlidhur ankimit, *statement* bankar datë 06.07.2022 dhe 07.07.2022, trupi gjykues konstaton se ato pasqyrojnë të dhëna se në llogari të subjektit të rivlerësimit kanë ekzistuar shumat e deklaruara prej tij, por nuk vërtetohet ligjshmëria e burimit të krijimit të tyre, për rrjedhojë, këto akte duken pa relevancë në vlerësimin e këtij shkak ankimi.

28.5/e. Lidhur me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.06.2022, të vëllait të subjektit, z. F. H., e depozituar vetëm pas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se ajo nuk është e shoqëruar me ndonjë dokumentacion ligjor provues të kohës, për sa i takon sasisë dhe mënyrës së të ardhurave të përfituara nga vëllezërit e subjektit apo të pagesës së detyrimeve tatimore që do t'i bënin ato, një burim të ligjshëm financiar. Aq më tepër që nga informacioni që përcjell kjo deklaratë, deklarohet se z. H. nuk ka pasur dokumentacion të rregullt qëndrimi gjatë viteve të emigrimit, duke u pranuar indirekt që ka punuar në mënyrë informale në ato vende.

28.5/ë. Lidhur me krahasimin që kryen subjekti i rivlerësimit të situatës së tij në procesin e rivlerësimit në raport me atë të subjekteve të tjerë, duke cituar vendimmarrjet e Kolegjit, trupi gjykues, megjithëse për këtë shkak ankimi ka mbajtur qëndrim më lart, në analizimin e shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale, vëren se situata faktike që paraqitet në këto vendime nuk është e njëjtë me atë të subjektit të rivlerësimit Astrit Halilaj. Konkretisht, për sa i përket referimit të subjektit të rivlerësimit në vendimin nr. 11/2018, të Kolegjit, lidhur me deklarimin e gjendjeve të likuiditeteve, trupi gjykues vëren se në vendimin e Kolegjit nr. 11/2018, vërtet subjekti nuk i ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve në deklaratat e interesave periodikë vjetorë të pasurisë, por ka rezultuar e provuar nga hetimi administrativ se burimi i krijimit të këtyre pasurive është i ligjshëm dhe vjen nga puna e personave të lidhur, në ndryshim nga situata financiare e subjektit, i cili nuk ka arritur të vërtetojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre depozitave, pavarësisht deklarimit të tyre në DIPP-të vjetore.

28.5/f. Lidhur me referimin e subjektit në vendimin nr. 15/2019 të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit D. RR., për ligjshmërinë e depozitës në bankë, trupi gjykues vëren se Kolegji në këtë rast, jo vetëm që nuk e ka konsideruar të gjithë shumën e pretenduar nga subjekti RR., për të ardhurat nga emigracioni, por analizën financiare të tij e ka bërë në një situatë hipotetike, duke llogaritur një pjesë të saj vetëm në funksion të kontrollit nëse kjo shumë mund të afektonte analizën e tij financiare, për rrjedhojë, referimi i subjektit në këtë vendim të Kolegjit duket jorelevant.

28.5/g. Në përfundim të analizimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar ekzistencën e ndonjë marrëdhënieje pune të vëllezërve të tij në vendet

dhe në periudhat e pretenduara. Në këto kushte, ligjshmëria e këtij burimi financiar mbetet në nivel deklarativ dhe i pambështetur në prova dhe, për pasojë, e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit, duke mos i konsideruar këto depozita të krijuara me burime të ligjshme financiare, përfshirë edhe shumën 4.252 USD, e paguar në favor të palës shitëse “{***}” ShPK, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet dhe të përlllogaritet në analizën financiare për këtë pasuri.

28.6. Lidhur me të ardhurat vjetore të deklaruara prej subjektit të rivlerësimit, si një nga burimet për blerjen e apartamentit. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka përcaktuar masën financiare të përdorur nga ky burim për pasurinë në fjalë. Nga totali i shumës së paguar në vitin 2010, prej 20.000 eurosh, duke zbritur shumën prej 10.000 eurosh, e cila ishte marrë hua, dhe rreth 3.200 euro³⁸, tërhequr nga depozita në ProCredit Bank, shuma e mbetur për t’u likuiduar nga të ardhurat vjetore, në vitin 2010, ka qenë 6.800 euro.

28.6/a. Nga analizimi i DIPP-ve ndër vite, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar gjendje *cash* si të mbartur deri në vitin 2010, që të mund të ishte përdorur për blerjen e apartamentit. Komisioni ka analizuar mundësinë e familjes së subjektit për të likuiduar shumën prej 6.800 eurosh vetëm me të ardhurat e vitit 2010, nga ku ka rezultuar se, gjatë vitit 2010, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë realizuar të ardhura në masën 2.579.211 lekë, të cilat duken të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e familjes gjatë vitit 2010 dhe për të kryer pagesën e kështit të apartamentit, prej 6.800 eurosh.

28.6/b. Lidhur me pretendimin e subjektit, *se Komisioni, në mënyrë të padrejtë, nuk ka përfshirë në mënyrë të saktë, në analizën financiare për vitin 2010, të ardhurat nga paga të subjektit dhe bashkëshortes së tij*, trupi gjykues konstaton se tabela nr. 3 e vendimit të Komisionit, që i referohet subjektit në ankim, nuk është kuptuar drejt prej tij, pasi në zërin *të ardhura të vitit*, Komisioni ka përfshirë vetëm pjesën e të ardhurave të përdorura për krijimin e shumës 20.000 euro, në vitin 2010, me burim të ardhurat vjetore, vetëm shumën 6.800 euro, të konvertuar në vlerën 943.908 lekë. Balanca negative prej (1.832.292) lekësh është totali i shumës së marrë hua (10.000 euro) dhe shumës së tërhequr nga banka (3.200 euro). Pra, në këtë tabelë, nuk pasqyrohet analiza e të ardhurave dhe e shpenzimeve të vitit 2010, por vetëm analiza e burimeve të krijimit të shumës 20.000 euro. Nga kontrolli i vendimit të Komisionit rezulton se, në paragrafin 46 të tij, është analizuar mundësia e familjes së subjektit të rivlerësimit për të likuiduar shumën prej 6.800 eurosh, vetëm me të ardhurat e vitit 2010, nga ku ka rezultuar se, gjatë vitit 2010, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë realizuar të ardhura në masën 2.579.211 lekë, pra Komisioni i ka përlllogaritur këto të ardhura në analizën financiare referuar dokumentacionit³⁹ të dorëzuar së bashku me deklaratën *vetting*, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

28.6/c. Sa më sipër analizuar, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën prej -1.832.292 lekësh, për pagesën e kështit të parë prej 20.000 eurosh.

28.7. Trupi gjykues konstaton se për blerjen e apartamentit në Vlorë, në vlerën totale prej 35.000 eurosh, subjekti ka deklaruar kryerjen e pagesave si vijon: (i) 20.000 euro në vitin 2010; (ii) 8.000 euro në vitin 2011; (iii) 5.000 euro në vitin 2012; dhe (iv) 2.000 euro në vitin 2013. Për pasojë, vijoi analizimin e pagesës tjetër të kështit prej 8.000 eurosh në vitin 2011, nga ku rezultoi se, përveç të

³⁸ Ekuivalenti i shumës 4.252 USD.

³⁹ Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 26.10.2016, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave, të ardhurat e subjektit nga paga, për vitin 2010, janë 1.605.625 lekë, ndërsa sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 25.10.2016, të INSIG ShA, të ardhurat neto nga paga e bashkëshortes, SH. H., për vitin 2010, janë 973.586 lekë.

ardhurave nga pagat, në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe të ardhura nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi Pajero”, të blerë po atë vit nga Ministria e Brendshme⁴⁰.

28.7/a. Lidhur me pagesën e kështit të dytë, prej 8.000 eurosh, kryer në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni, në mënyrë të padrejtë, nuk ka njohur si të ardhur të ligjshme diferencën ndërmjet çmimit të shitjes dhe blerjes, në vlerën prej 762.500 lekësh, për automjetin tip “Mitsubishi Pajero”, me arsyetimin se nuk është paguar tatimi mbi fitimin, duke kërkuar nga Kolegji që shuma e përfituar nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi Pajero”, të konsiderohet si e ardhur me burim të ligjshëm financiar.

28.7/b. Në analizë të pretendimit të subjektit, trupi gjykues, nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, konstaton se, në bazë të kontratës së shitblerjes nr. {***}, datë 21.02.2011, pala shitëse, Ministria e Brendshme, i ka shitur automjetin e llojit “Mitsubishi Pajero”, me procedurën e ankandit, me të drejtë parablerjeje blerësit Astrit Halilaj, kundrejt çmimit 437.500 lekë. Në datën 23.09.2011, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. 3149/487, subjekti i rivlerësimit ia ka shitur këtë automjet shoqërisë “{***}” ShPK, kundrejt çmimit prej 1.200.000 lekësh. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e *autoveturës {***}, në vlerën 1.200.000 lekë, me kontratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.09.2011.*

28.7/c. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrolli analizën financiare të vitit 2011 dhe fillimisht konstatoi se Komisioni ka pasqyruar blerjen e pasurisë “automjet” tip “Mitsubishi Pajero”, nga subjekti, në vitin 2011, por nuk ka përfshirë të ardhurat nga shitja e tij, në masën e njohur në vendim. Nga korrigjimi i këtij veprimi, në analizën financiare rezulton se pamundësia financiare për pagesën e shumës 8.000 euro, në vitin 2011, për blerjen e apartamentit në Vlorë, reduktohet në një balancë negative prej - 230.123 lekësh, krahasuar me balancën prej - 781.344 lekësh, të llogaritur nga Komisioni.

28.7/ç. Pavarësisht këtij konstatimi, në kushtet kur e ardhura e përfituar nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi Pajero”, në vlerën prej 1.200.000 lekësh është përfshirë në analizën financiare të vitit 2011 (analizuar më poshtë në këtë vendim), dhe si pasojë subjekti ka rezultuar me një balancë pozitive prej 532.377 lekësh, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për kryerjen e pagesës prej 8.000 eurosh, për blerjen e apartamentit në Vlorë, në vitin 2011, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit për këtë shkak ankimi është i bazuar.

28.8. Lidhur me pagesën e kështit të fundit, prej 2.000 eurosh, në muajin dhjetor të vitit 2013, në ndryshim nga Komisioni, trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për kryerjen e kësaj pagese. Ky vlerësim erdhi pasi u konstatua se Komisioni në vendim, krahasuar me rezultatet e hetimit, ka reduktuar shpenzimet totale të subjektit për vitet 2011 – 2013, si pasojë e reduktimit të shpenzimeve të udhëtimit, por ky ndryshim nuk është pasqyruar në tabelën e analizës së burimeve për këtë pasuri, të hartuar nga Komisioni. Pas korrektimit të këtyre vlerave, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte *burime financiare të ligjshme për kryerjen e pagesës prej 2.000 eurosh, në vitin 2013.*

28.9. Trupi gjykues i Kolegjit, pas kontrollit të analizës financiare të periudhës 2010 – 2013 dhe korrigjimit të disa vlerave të kësaj analize, në përmbledhje të analizimit të tri burimeve të deklaruara

⁴⁰ Sipas ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë” dhe VKM-së nr. 1242, datë 16.12.2009, “Për rregullat e funksionimit të Komisionit të Ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës që nxirret në ankand, si dhe mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor”.

për krijimin e kësaj pasurie dhe verifikimit të mundësisë financiare të subjektit për blerjen e apartamentit në Vlorë, vlerëson se ai nuk justifikon me burime të ligjshme financiare shumë prej - 1.961.715 lekësh, për blerjen e apartamentit në Vlorë, në vlerën 35.000 euro, në ndryshim nga Komisioni, të cilit i ka rezultuar një vlerë më e lartë.

28.10. Për pasurinë “vendparkim”, e blerë në vlerën 5.000 euro, në muajin gusht të vitit 2014, Komisioni në vendim ka arritur në përfundimin se, për aq kohë sa nuk janë paraqitur pretendime apo prova për të kundërshtuar/ndryshuar atë, rezultati i njoftuar për këtë pasuri nuk ndryshon, duke mbetur kështu një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në masën 134.157 lekë, ndonëse në vetvete kjo pamundësi financiare me burime të ligjshme nuk mund të sjellë pasoja.

28.10/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se balanca negative e konstatuar nga Komisioni, në vlerën prej - 134.157 lekë, nuk qëndron, pasi Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e tjera që kanë shërbyer si burim për blerjen e vendparkimit, shumë prej 365.000 lekësh, tërhequr nga bashkëshortja e tij nga llogaria e saj e depozitës. Sipas subjektit, më datë 03.06.2014, punëdhënësi i saj i ka kaluar shumë prej 1.345.500 lekësh, si shpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës dhe nëse vetëm kjo shumë do të ishte marrë parasysh nga Komisioni, ai do të rezultonte me balancë pozitive në shumë prej 230.843 lekësh, në lidhje me blerjen e pasurisë “vendparkim”.

28.10/b. Nga analizimi i dokumentacionit për pasurinë “vendparkim”, ndodhur në Vlorë, trupi gjykues konstaton se kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën përpara fillimit të detyrës si prokuror, në vitin 2016, në vlerën 5.000 euro dhe me burim nga kursimet e familjes, deklarim ky i cili është përsëritur dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*.

28.10/c. Bashkëngjitur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratë noteriale të administratorit të shoqërisë shitëse “{***}” ShPK, i cili, ndër të tjera, ka deklaruar se, në muajin gusht të vitit 2014, z. Astrit Halilaj ka blerë edhe një vendparkim me vlerë 5.000 euro, shumë kjo e likuiduar *cash* në momentin e blerjes. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti është shprehur se blerja nuk është kryer me kontratë noteriale, pasi është dakordësuar me marrëveshje që kontrata të lidhej në momentin e kalimit të pronësisë së apartamentit. Subjekti ka shtuar gjithashtu se burimi i krijimit ka qenë nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes, si dhe një shumë rreth 1.400.000 lekë, kaluar bashkëshortes nga INSIG ShA, në muajin qershor 2014, për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës.

28.10/ç. Nga dokumentacioni i paraqitur prej subjektit, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, rezulton se INSIG ShA, me shkresën nr. {***} prot., datë 25.10.2016, ka bërë me dije se, më datë 01.06.2014, bashkëshortja e subjektit ka përfituar, nga shpërblim page dhe leje të zakonshme, me rastin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës, shumë neto 1.345.500 lekë, si dhe ka përfituar shumë prej 1.560.000 lekësh, në datën 19.01.2016, si shpërblim page me vendim gjykate⁴¹.

28.10/d. Komisioni ka kryer analizën financiare të periudhës janar – gusht 2014, duke konsideruar tërheqjet e kryera nga llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortes së tij, gjatë kësaj periudhe. Po ashtu janë përlllogaritur shpenzimet e familjes gjatë së njëjtës periudhë, duke mos përfshirë në këtë

⁴¹ Me qëllim qartësimin mbi përfitim të dy dëmshpërblimeve për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, edhe në vitin 2014, edhe në vitin 2016, me anë të vendimit të gjykatës, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 4, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqiste vendimin e sipërcituar, si dhe të shpjegonte arsyet e këtyre përfitimeve. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se dëmshpërblimi i parë, i dhënë bashkëshortes nga shoqëria INSIG, ka qenë për mosrespektimin e afatit të njoftimit, sipas nenit 143 të Kodit të Punës dhe shpërblimit për vjetërsi, sipas nenit 145 të Kodit të Punës. Ndërkohë, bashkëshortja e subjektit ka kërkuar me anë të kërkesëpadisë dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të kontratës, sipas nenit 155 të Kodit të Punës, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me anë të vendimit nr. {***}, datë 22.09.2014. Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi me anë të vendimit nr. {***}, datë 19.11.2015.

llogaritje shpenzimet e arredimit dhe shlyerjen e kështit të huas prej 2.000 eurosh, për sa kohë nuk mund të përcaktohet një moment i saktë i kryerjes së tyre. Në përfundim të sa më sipër, ka rezultuar se për blerjen e vendparkimit në analizë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej - 134.157 lekë.

28.10/dh. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon dokumentacionin bankar të administruar për këtë qëllim dhe i rezultoi se, në llogarinë bankare të pagës të bashkëshortes së subjektit, me nr. {***}, pranë BKT Bank, shuma prej 1.345.500 lekësh është transferuar nga INSIG ShA, në llogari të saj, në datën 03.06.2014. Nga kjo shumë, një pjesë prej 935.000 lekësh është transferuar në llogarinë e depozitës dhe ka qëndruar e investuar së paku deri në muajin shtator 2014, ndërsa shuma prej 365.000 lekësh është tërhequr prej saj, deri në fund të muajit gusht 2014. Shuma totale e tërhequr nga bashkëshortja e subjektit për periudhën janar – gusht 2014 është 723.000 lekë, nga e cila shuma prej 358.000 lekësh është tërhequr para datës 03.06.2014 dhe shuma prej 365.000 lekësh është tërhequr në periudhën 05.06.2014 – 28.08.2014. Gjithashtu, nga kontrolli i llogarisë bankare të pagës së subjektit të rivlerësimit, me nr. {***}, pranë Raiffeisen Bank rezulton se, gjatë periudhës janar – gusht 2014, subjekti ka tërhequr shumën totale prej 615.000 lekësh.

28.10/e. Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj konstaton se totali i të ardhurave të tërhequra nga banka, për periudhën janar – gusht 2014, për subjektin dhe bashkëshorten e tij, është 1.338.000 lekë, e njëjtë me shumën e të ardhurave të përlllogaritura nga Komisioni në analizën e tij financiare, për rrjedhojë, edhe shuma prej 365.000 lekësh, rezulton e tërhequr nga llogaria e bashkëshortes së tij dhe e përfshirë në analizën financiare të pasurisë.

28.10/ë. Sa më sipër analizuar, trupi gjykues konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se një pjesë e të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja e subjektit, nga shpërblim page dhe leje të zakonshme, me rastin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës, nuk janë përfshirë në analizën financiare për blerjen e pasurisë “vendparkimi”, është i pabazuar. Për rrjedhojë, ashtu si edhe Komisioni, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, prej - 134.157 lekësh, për blerjen e pasurisë “vendparkim”, në muajin gusht të vitit 2014.

28.11. Për pasuritë “apartament banimi me sipërfaqe 79 m²” dhe “vendparkim”, në Vlorë, trupi gjykues, ashtu si Komisioni, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie. Trupi gjykues vlerëson se ligjshmëria e të ardhurave të pretenduara nga huaja, si dhe depozitat e krijuara me të ardhurat e vëllezërve nga puna e tyre në emigracion, mbeti në nivel deklarativ dhe e pambështetur në prova dhe ligj. Duke përfshirë në analizën financiare një pjesë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupit gjykues i rezultoi një diferencë më e vogël se e Komisionit, konkretisht, subjekti i rivlerësimit rezulton me një mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën totale prej - 2.095.872 lekësh, e ndarë respektivisht në shumën prej - 1.961.715 lekësh, për blerjen e apartamentit dhe shumën prej - 134.157 lekësh, për blerjen e vendparkimit.

28.12. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për këtë pasuri, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, e ligjit nr. 84/2016.

29. Lidhur me dy njësi shërbimi, me vendndodhje në Kullën {*} nr. {***}, në {***}, Tiranë,** Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit lidhur me këto pasuri ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, bazuar në parashikimet e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

29.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se të drejtat reale mbi këto pasuri i kanë kaluar atij nga vëllai F. H., në vitin 2014, sipas një marrëveshjeje kompensimi, nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***}, datë 08.09.2014. Subjekti kërkon që shuma prej 32.000 USD, e përdorur në vitin 2000 për blerjen e pasurive me burim financimi nga puna në emigracion e vëllait të tij, në vitet 1999 – 2001 në Gjermani, të përfshihet në analizën financiare si e ardhur nga burim i ligjshëm. Subjekti pretendon se Komisioni ka shkelur parimin e propocionalitetit, pasi nuk mund t'i jepet një masë disiplinore për një shkelje të prezumuar, sepse ka ndodhur para 22 vitesh dhe 14 vite para se të ushtronte funksionin e prokurorit.

29.2. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të këtij shkaku ankimi, mori në shqyrtim aktet që ndodhen në fashikujt e përcjellë nga Komisioni lidhur me këtë pasuri, nga ku rezulton se:

29.2/a. Në deklaratën përpara fillimit të detyrës si prokuror, në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, me anë të kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.9.2000, vëllai i tij, z. F. H., ka blerë njësi shërbimi (dyqane) nr. {***} dhe nr. {***}, me sipërfaqe 79 m², me vlerë 32.000 USD, me burim nga të ardhurat nga emigracioni. Të drejtat reale për këtë pasuri kanë kaluar te z. Astrit Halilaj, me aktin noterial nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.09.2014. Të njëjtin deklaram, subjekti i rivlerësimit ka kryer edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke shtuar se pronat janë në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t.

29.2/b. ALUIZN-i ka informuar⁴² Komisionin për lejen e legalizimit në favor të shtetasit Astrit Halilaj për objektin “Njësi shërbimi”, Kulla {***} nr. {***}, {***}, me sipërfaqe ndërtimi 76 m², gjithashtu ZVRPP/AShK Tiranë,⁴³ duke konfirmuar pronësinë në emër të subjektit të rivlerësimit për pasuritë e llojit “njësi shërbimi me sipërfaqe 38 m²”, secila.

29.2/c. Bashkëngjitur deklaratës *vetting*, subjekti ka depozituar kontratë sipërmarrje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., të datës 28.09.2000, e nënshkruar mes shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK dhe porositësit F. H., për ndërtimin e një pasurie të llojit dyqan, me sipërfaqe të përgjithshme 76 m², në katin përdhe të kullës nr. {***}, kundrejt çmimit total 32.000 USD. Në këtë kontratë, palët kanë përcaktuar kryerjen e pagesave me këste⁴⁴.

29.2/ç. Nga analizimi i kontratës së sipërmarrjes së sipërcituar, trupi gjykues konstaton se në pjesën përshkruese të palëve, për porositësin F. H. është shënim “me prokurë”, por ndërkohë te nënshkrimi për porositësin ka firmosur vetë subjekti i rivlerësimit, pa përcaktuar prokurën, ekstremitetet e saj dhe përfaqësuesin apo të përfaqësuarin, si dhe nuk rezulton t'i jetë bashkëngjitur kësaj kontrate ndonjë prokurë.

29.2/d. Gjithashtu, bashkëngjitur deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti ka depozituar: “*deklaratë noteriale për heqje dorë nga pronësia*”, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.09.2014, të lëshuar

⁴² Me shkresën nr. {***}, datë 08.05.2017, ka bërë me dije se në favor të shtetasit Astrit Halilaj është regjistruar leja e legalizimit nr. {***}, datë 11.04.2017, në bazë të VKM-së nr. 439, datë 02.07.2014 “Për përcaktimin e procedurave të legalizimit të ndërtimeve pa leje, shtesave anësore apo në lartësi, të ndërtuara nga shoqëria ‘{***}’ ShPK”, e ndryshuar.

⁴³ Shkresë nr. {***} prot., datë 16.08.2017 dhe me shkresën nr. {***}, datë 22.11.2018, ZVRPP/ASHK Tiranë.

⁴⁴ Pagesat janë përcaktuar si vijon: (i) 10.000 USD, në momentin e nënshkrimit të kontratës; (ii) 4.000 USD në datën 15.11.2000; (iii) 4.000 USD në datën 15.01.2001; 4.000 USD në datën 15.03.2001; 4.000 USD në datën 15.05.2001 dhe 6.000 USD me marrjen e çelësve në dorëzim.

nga vëllai i tij, z. F. H., i cili ka deklaruar se: “...Unë heq dorë nga vazhdimi i procedurave të legalizimit të këtyre dy njësive, duke i kaluar këto të drejta në emër të vëllait tim, Astrit Halilaj, i cili ka të drejtë të bëjë kalimin e pronësisë së këtyre dy njësive në emër dhe me shpenzimet e tij, duke përfshirë dhe regjistrimin e këtyre pronave në emër e për llogari të tij. Shkaku që unë heq dorë, është pasi kemi rënë dakord që këto dy njësi janë pjesë që përfiton vëllai Astrit Halilaj nga ndarja e pasurisë së trashëguar dhe të fituar së bashku para vitit 2001”.

29.3. Nisur nga sa është përshkruar në deklaratën noteriale të sipërcituar, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, për të bërë me dije mbi pasurinë e trashëguar përpara vitit 2001 dhe ndarjen e saj, duke paraqitur edhe dokumentacionin përkatës. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, sa më sipër, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: “Kemi rënë dakord për variantin e kompensimit në natyrë, duke i dhuruar vëllait⁴⁵ një sipërfaqe ambienti të njëjtë të përshtatshme për servis makinash ose një apartament banimi në truallin e banesës time ekzistuese. Lagjja ku banoj, është në zhvillim, ku vetëm rreth 4 banesa kanë ngelur shtëpi private dhe pjesa tjetër është zhvilluar me pallate. Në këto rrethana janë ofruar disa firma ndërtuese për të lidhur marrëveshje, për të zhvilluar pronën”.

29.3/a. Me qëllim qartësimin e situatës mbi deklarin e dhënë nga vëllai i tij, në vitin 2014, Komisioni e ka ripyetur subjektin e rivlerësimit, si dhe e ka ftuar për të paraqitur dokumentacionin përkatës të kompensimit me sipërfaqe të njëjtë, të përmendur në përgjigjet e pyetësorit nr. 3. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ka shpjeguar se: “Dua të theksoj se ideja e kompensimit në natyrë më ka lindur mua, kohë pasi është bërë deklarata noteriale. Është një premtim për të ardhmen, në rast se do të zhvillohet prona, trualli në banesën ekzistuese, kjo gjë nuk është formalizuar me ndonjë akt noterial, por thjesht një premtim verbal”.

29.3/b. Sikurse ka rezultuar edhe nga deklarimi në deklaratën e pasurisë vetting, këto pasuri janë dhënë me qira nga ana e subjektit të rivlerësimit referuar kontratave të qirasë të vitit 2015 dhe vitit 2016⁴⁶. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka bërë me dije se dyqanet më parë janë dhënë me qira nga vëllai i tij, duke vënë në dispozicion dy kontrata qiraje, të vitit 2012 dhe 2015⁴⁷.

29.4. Lidhur me burimin e ligjshëm të përdorur për blerjen e njësive të shërbimit, trupi gjykues konstaton se për të saktësuar kohën dhe mënyrën e kryerjes së pagesave për blerjen e njësive të shërbimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision mandatpagesat⁴⁸ përkatëse, nga të cilat rezulton se, në total, shuma e paguar sipas mandateve është 26.000 USD. Sa i takon pagesës së kështit të fundit, subjekti ka shpjeguar se është paguar më datë 08.12.2001, por ka bërë me dije se nuk disponon mandatpagesën përkatëse. Për të provuar shlyerjen e detyrimit me palën shitëse, subjekti ka

⁴⁵ ASHK Tirana Rurale 1, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.04.2020, ka informuar se F. H. ka të regjistruar pasurinë “pemëtore 293.40m²”, me nr. {***}, ZK {***}, përfituar me ndarje pasurie, si dhe pasurinë “truall me sipërfaqe 106.6 m²” dhe “ndërtesë me sipërfaqe 106.6 m²”, me nr. {***}, në ZK {***}. Në pasurinë me nr. {***}, në ZK {***}, ndodhet një godinë banimi 2 kate dhe papafingo me sip. 106.6 m², pajisur me leje legalizimi, datë 16.06.2015. Referuar shkresës nr. {***} prot., datë 28.2.2020, të DPPPP, ka rezultuar se shtetasi F. H. ka nënshkruar një kontratë dhurimi, ku palë dhuruese është shtetasi Z. H. (vëllai tjetër i subjektit), me objekt “dhurim i pasurisë së llojit pemëtore, të ndodhur në Tiranë, me sipërfaqe 400 m²”.

⁴⁶ Komisioni ka administruar kontratën e qirasë të vitit 2015, me shtetasen F. B., me vlerë 20.000 lekë, dhe kontratën e qirasë të vitit 2016, me shtetasen I. H., për njësinë e dytë të shërbimit, me vlerë 20.000 lekë, ku nga çmimi i qirasë do të zbriten detyrimet tatimore.

⁴⁷ Kontratë qiraje e lidhur më datë 15.02.2012 dhe kontratë qiraje e lidhur më datë 16.01.2015, me shoqërinë tregtare Autoshkolla “{***}” ShPK, për ushtrimin e aktivitetit.

⁴⁸ Mandatpagesat janë me përshkrimet si në vijim: 6.000 USD, klienti F. H., datë 22.09.2000; 4.000 USD, klienti F. H., datë 26.09.2000; 4.000 USD, klienti F. H., datë 23.11.2000; 4.000 USD, klienti F. H., datë 19.02.2001; 4.000 USD, klienti F. H., datë 17.04.2001; 4.000 USD, klienti F. H., datë 26.09.2001.

paraqitur një dokument të titulluar *akt-mbarim kontrate*, të firmosur nga shtetasi E. S. M., në të cilën përshkruhet se: “*F. H. ka mbyllur kontratën e shitblerjes për dyqanet nr. {***} dhe nr. {***}*”, por konstatohet që ky vërtetim është pa datë.

29.4/a. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të paraqitur dokumentacion që provon burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 32.000 USD, prej vëllait të tij, z. F. H., e cila ka shërbyer si burim për blerjen e njërive, subjekti ka shpjeguar se: “*Burimi i krijimit të të ardhurave prej 32.000 USD, për blerjen e njërive të shërbimit nga shoqëria ‘{***}’ ShPK, është puna në emigracion e vëllait, F. H., gjatë viteve 1999, 2000 dhe 2001, i cili ka punuar në ndërtimtari, në Gjermani. Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, më shumë se 20 vite, nuk mund të sigurohen dokumente provuese nga autoritetet gjermane. Paratë janë krijuar nga puna e ndershme dhe janë transferuar në Shqipëri me persona të besuar dhe me Western Union*”. Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka sqaruar se vëllai i tij nuk ka qenë pajisur me dokumente në Gjermani dhe, pas kalimit të 20 viteve, është i vështirë sigurimi i dokumentacionit për të provuar burimin e ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e njërive.

29.4/b. Gjithashtu, nga aktet e dosjes së Komisionit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision deklaratën noteriale të datës 17.06.2022, të vëllait të tij, F. H., i cili ka deklaruar se ka emigruar nga viti 1999 në Gjermani, më pas nga viti 2005 në Britaninë e Madhe dhe se, nga puna e ligjshme gjatë këtyre viteve, ka fituar të ardhura, rreth 60.000 USD, të cilat ia ka dërguar vëllait të tij, Astrit Halilaj, nëpërmjet personave të ndryshëm, por edhe me Western Union. Në këtë deklaratë, vëllai i subjektit, F. H., ka deklaruar se shuma prej 32.000 USD është investuar për blerjen e dyqaneve në Kullat {***}.

29.5. Trupi gjykues vendosi të ndalej fillimisht në përcaktimin e statusit të vëllait të subjektit, nisur nga fakti që këto dy njësi shërbimi janë deklaruar prej tij si të krijuara me të ardhurat nga puna në emigracion e vëllait F. H. Trupi gjykues vëren se këto pasuri janë deklaruar nga subjekti në funksion të procesit të rivlerësimit kalimtar, pasi ato prej shumë vitesh janë përfutur prej tij pa kundërshtim, si dhe janë regjistruar në emër të tij, i cili ka gëzuar dhe vijon të gëzojë plotësisht të drejtat reale nëpërmjet dhënies së tyre me qira. Trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë është deklaruar se pasuritë janë të dhuruara atij nga vëllai F. H., bazuar në nenin 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, ky i fundit do të konsiderohet person tjetër i lidhur, e për pasojë, me detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të krijuara për blerjen e pasurisë.

29.5/a. Trupi gjykues e vlerëson të pambështetur në fakte dhe prova pretendimin e subjektit mbi përfitimin e këtyre pasurive si rezultat i këmbimit të tyre me një pasuri tjetër, pasi konstaton se nga plotësimi i deklaratës së parë të interesave pasurorë të vitit 2003 e në vijim, subjekti i rivlerësimit nuk ka rezultuar që të ketë deklaruar apo përcaktuar/shënuar ndonjë pasuri tjetër apo të drejta reale të përbashkëta me vëllezërit, që të passillnin kompensimin në të ardhmen të ndonjë pasurie të fituar para vitit 2001.

29.5/b. Trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion të kohës, që të provojë dërgimin e parave nga vendi i origjinës, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave nga emigracioni të vëllait të tij, që kanë mundur më pas blerjen e pasurive objekt shqyrtimi. Ky detyrim i tij ka qenë parashikuar edhe në Udhëzimin e Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, të datës 10.10.2016, sipas të cilit, në pikën 21, parashikohet se: “*Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga emigracioni prej subjektit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e*

deklarimit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë”, për rrjedhojë, vlerësoi se pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ.

29.5/c. Gjithashtu, përveç faktit se nuk është provuar burimi i ligjshëm i krijimit të pasurive në fjalë, duket se nuk ka logjikë ekonomike në veprimin e kryer prej vëllait të subjektit, sa i takon heqjes dorë prej tij nga pronësia e dy dyqaneve, për sa kohë nuk ka rezultuar ndonjë kompensim në asnjë formë mes subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij, as me pasuri të trashëguara më herët dhe as me apartament në tokën ekzistuese të subjektit. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit ⁴⁹ nr. 2, ka shpjeguar se qëllimi i marrjes së dy njësive të shërbimit, ka qenë për ushtrimin e aktivitetit të avokatisë prej tij dhe bashkëshortes, ndërkohë që ai ka së paku 7 vite që fiton të ardhura nga qiradhënia mbi këto dy njësi.

29.5/ç. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka mbajtur një standard të dyfishtë, pasi i njëjti trup gjykues ka bërë një vlerësim të ndryshëm, për shumën parash disa herë më të mëdha, të pajustificuara nga emigracioni, duke konfirmuar në detyrë subjektin A. D., trupi gjykues, megjithëse vëren se pretendimeve për aplikimin e standardeve të dyfishta i është dhënë përgjigje në analizimin e pretendimeve të subjektit të kërkesave me natyrë procedurale, trajtuar më lart në këtë vendim, sqaron se vendimi i Komisionit që i përket subjektit të rivlerësimit A. D., të cilit i referohet subjekti, pasi është ankimuar nga Komisioneri Publik, në Kolegj, ky i fundit e ka ndryshuar atë, duke e shkarkuar nga detyra këtë subjekt.

29.6. Në përfundim, për 2 (dy) pasuritë “njësi shërbimi nr. {***} dhe nr. {***}”, të ndodhura në Kullën nr. {***}, {***}, Tiranë, trupi gjykues, ashtu si Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor, si dhe nuk arriti të shpjegojë në mënyrë shteruese e bindëse ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të krijuara nga vëllazërit e tij në emigracion, të cilat kanë shërbyer për blerjen e pasurive “njësi shërbimi”, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 30.** Lidhur me pasurinë e luajtshme, “automjet” tip “Mercedes - Benz”, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit, *se ai ka një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 558.321 lekësh për blerjen e kësaj pasurie*, është i pambështetur në prova dhe i palogjikshëm nga ana financiare. Sipas subjektit, si burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes - Benz” kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e automjetit tjetër tip “Mitsubishi Pajero” dhe Komisioni, në mënyrë të padrejtë, nuk e ka njohur si të ardhur të ligjshme diferencën ndërmjet çmimit të shitjes dhe blerjes, prej 766.500 lekësh, për automjetin tip “Mitsubishi Pajero”. Sipas subjektit, përveç sasive të parave të tërhequra në bankë për blerjen e automjetit tip “Mercedes - Benz”, ai ka pasur gjendje *cash* në banesë në sasi të mëdha, në shumën 1.400.000 lekë, të deklaruara para fillimit të detyrës. Madje, sipas subjektit, mundësia financiare e tij konfirmohet edhe nga vetë Komisioni në analizën e burimeve për krijimin kursimeve në *cash*.

30.1. Trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim, pasi ka vlerësuar se pamundësia financiare për krijimin me burime të ligjshme të kësaj pasurie është relativisht e ulët (558.321 lekë), si dhe duke

⁴⁹ Në përgjigje të pyetjes nr. 9 të pyetësorit nr.2, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: *Këto njësi janë legalizuar në emrin tim, sipas një marrëveshje me vëllain F. H., me qëllim për t'u përdorur si studio ligjore nga unë dhe bashkëshortja ime, për faktin se në atë kohë ishim të dy të pa punë dhe dispononim licencat e avokatit... Të gjendur të dy brenda një muaji pa punë, menduam të hapnim një studio ligjore, projekt i cili nuk u realizua për faktin se unë fillova punë në sistemin e Prokurorisë, fillimisht si Oficer i Policisë Gjyqësore dhe në prill 2016 jam dekretuar prokuror.*

mbajtur parasysh se mjetet monetare të përdorura në këtë rast nuk kanë mbetur të paidentifikuara, pasi kanë rrjedhur nga një shitje pasurie (edhe pse ato nuk mund të kualifikohen në tërësinë e tyre si një burim i ligjshëm), pamjaftueshmëria e konstatuar për këtë automjet nuk mund të përbëjë një shkak penalizues për subjektin e rivlerësimit. Kjo balancë negative e konstatuar prej Komisionit ka ardhur si rezultat i mospërfshirjes së të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi Pajero”, në masën 762.500 lekë (si diferencë mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së mjetit). Sipas Komisionit, këto të ardhura nuk janë konsideruar me burim të ligjshëm financiar në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar detyrimet tatimore përkatëse mbi këto të ardhura të gjeneruara.

30.2. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në deklaratën përpara fillimit të detyrës si prokuror, në vitin 2016, automjetin tip “Mercedes - Benz”, blerë në datën 03.04.2016, me vlerë 6.000 euro dhe 180.000 lekë taksë doganore, me burim nga të ardhurat nga shitja e autoveturës me targë {***}, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.09.2013. Të njëjtin deklaramin subjekti e ka kryer edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor⁵⁰ ka konfirmuar faktin se në emër të subjektit figuron i regjistruar automjeti tip “Mercedes - Benz” me targë {***}.

30.3. Trupi gjykues, nisur nga fakti subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, si burim për krijimin e pasurisë “automjet” tip “Mercedes - Benz” ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë tjetër “automjet” tip “Mitsubishi Pajero”, me targë {***}, mori në shqyrtim dokumentacionin për këtë pasuri të luajtshme, nga ku rezultoi se:

30.3/a. Me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.02.2011, Ministria e Brendshme i ka shitur automjetin tip “Mitsubishi Pajero”, me ankand,⁵¹ me të drejtë parablerje, blerësit Astrit Halilaj, kundrejt çmimit 437.500 lekë. Subjekti i rivlerësimit këtë automjet e ka shitur në datën 23.09.2011⁵², me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., shoqërisë “{***}” ShPK, kundrejt çmimit 1.200.000 lekë. Në deklaratën e interesave pasurorë periodikë të vitit 2011, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit nga Ministria e Brendshme në vlerën 437.500 lekë dhe më pas shitjen e tij në vlerën 1.200.000 lekë.

30.3/b. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni ka ftuar subjektin të shpjegonte arsyet e shitjes së mjetit brenda vitit me një çmim rreth 3-fish më të lartë, si dhe të paraqiste dokumentacionin që provon pagimin e detyrimeve përkatëse tatimore për të ardhurat e realizuara nga kjo shitje, sa i takon diferencës mes çmimit të shitjes dhe blerjes, prej 762.500 lekë. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka sqaruar se çmimi i shitjes ka qenë në përputhje me vlerën e tregut, pasi automjeti ka qenë në gjendje

⁵⁰ *DPShtRr, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.07.2017, ka bërë me dije se në emër të subjektit figuron i regjistruar automjeti me targë {***} dhe deri më datë 15.05.2012 ka qenë regjistruar automjeti me targë {***}. Ndërsa, me shkresën nr. {***} prot., datë 27.02.2020, DPShtRr-ja ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen e automjetit në analizë, përfshirë faturën e shitjes në gjuhën gjermane, sipas së cilës shtetasi S. P. i ka shitur subjektin të rivlerësimit, automjetin e llojit “Mercedes - Benz” E 220 CDI, vit prodhimi 2007, në shumën 6.000 euro. Subjekti i rivlerësimit ka kryer dhe zhdoganimin e këtij mjeti, në datën 04.05.2016, kundrejt tarifës 179.201 lekë, nga ku investimi total i subjektit për këtë pasuri ka qenë 990.821 lekë.*

⁵¹ *Sipas ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë” dhe VKM-së nr. 1242, datë 16.12.2009, “Për rregullat e funksionimit të Komisionit të Ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës që nxirret në ankand, si dhe mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor”.*

⁵² *Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar ky automjet nuk është shitur në vitin 2013, sikundër ka deklaruar subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*, por është shitur në vitin 2011.*

të mirë teknike. Ai ka shtuar se nuk i ka kryer ndonjë shërbim të rëndësishëm mjetit dhe nuk ka paguar ndonjë detyrim tatimor, pasi nuk ka pasur dijeni për një detyrim të tillë.

30.3/c. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, verifikoi lëvizjet bankare të llogarive të subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultoi se rreth 6 muaj përpara nënshkrimit të kontratës së shitjes, në datën 08.03.2011, shoqëria “{***}” ShPK ka transferuar në llogari të subjektit të rivlerësimit shumën prej 500.000 lekësh, me përshkrimin “*derdhur pagesa e makinës*”. Më pas, në datën 24.03.2011, vetë subjekti ka kryer një depozitim *cash* në llogari të tij, në shumën 700.000 lekë. Trupi gjykues konstaton se mjetet monetare të përdorura në këtë rast janë të identifikueshme, ashtu sikurse evidentohet më lart, veprimet janë kryer nëpërmjet transaksioneve bankare për këtë shitje, si dhe është deklaruar ky veprim juridik prej subjektit në DIPP-në e vitit 2011.

30.4. Lidhur me konkluzionin e Komisionit për mospërfshirjen në analizën financiare të subjektit të të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi Pajero”, në vitin 2011, si rezultat i mospagimit të detyrimeve tatimore për këto të ardhura, trupi gjykues analizoi pretendimin e subjektit në raport me legjislacionin tatimor që rregullon këto marrëdhënie si më poshtë:

30.4/a. Kolegji vlerësoi këtë qëndrim të Komisionit në konsideratë të legjislacionit të zbatueshëm, sipas të cilit nuk evidentohet/përcaktohet shprehimisht detyrimi për pagimin e tatimit mbi diferencën që vjen nga çmimi i shitjes me atë të blerjes së një pasurie të luajtshme. Gjithashtu sillet në vëmendje se, sipas dispozitave kushtetuese dhe interpretimit që u është bërë atyre nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese⁵³, përcaktimi i të ardhurave “të tatueshme” nuk është lënë në diskrecion të organeve ligjzbatuese”, por i është njohur vetëm ligjit, pasi neni 155 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë sanksionon se taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Për këto arsye, trupi gjykues vlerësoi se ndryshimi që ka pësuar ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me miratimin e ligjit nr. 9161, datë 18.12.2003, sipas të cilit, në nenin 8 të tij, që përcakton të ardhurat e tatueshme, u shtua një paragraf me përmbajtje: g) *të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë* – nuk duhet t’i nënshtrohen një interpretimi të zgjeruar, me rezultat përcaktimin e detyrimit për pagesën e tatimit për të ardhurat e krijuara, si pasojë e transaksioneve të shitblerjeve të automjeteve në kushtet e paqartësisë lidhur me shkallën tatimore, bazën e tatueshme, mënyrën e pagesës dhe agjentin tatimmbledhës. Përveç sa më sipër, Kolegji mori në konsideratë edhe qëndrimin e mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, lidhur me përcaktueshmërinë e këtij detyrimi të pasqyruar në shkresën e datës 25.05.2023, përcjellë në përgjigje të kërkesës së Kolegjit për informacion. Në këtë dokument pasqyrohet qëndrimi i këtij institucioni se, për qëllim të tatimit të të ardhurave personale, neni 8 i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi i Ministrisë së Financave, i miratuar në zbatim të tij nr. 5, datë 30.01.2006, i ndryshuar, nuk ka të përfshirë dhe/ose cituar si të ardhura të tatueshme, të ardhurat nga shitja e pasurisë së luajtshme (automjet për përdorim personal). Mbështetur në arsyetimin e bërë më sipër, trupi gjykues vlerësoi të konsiderojë të ligjshme të ardhurat e krijuara prej shitjes e përfitur nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi Pajero”, në vlerën 1.200.000 lekë dhe vlerësoi që e ardhura të përfshihet në analizën financiare dhe të konsiderohet si burim krijimi për pasurinë “automjet” tip “Mercedes - Benz”, blerë në datën 03.04.2016.

⁵³ Në vendimin nr. 16, datë 25.07.2008, të Gjykatës Kushtetuese, është arsyetuar se: “Marrëdhëniet e tatim-taksave janë marrëdhënie ligjore detyrimi ndërmjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe si të tilla ato mund të përcaktohen vetëm me ligj”. Shih: https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php

30.5. Për sa më sipër, në ndryshim nga Komisioni, duke konsideruar si të ligjshme të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi Pajero”, të analizuar më lart, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë me burime të ligjshme blerjen e automjetit tip “Mercedes - Benz”, të deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë *vetting*.

31. Në lidhje me të ardhurat nga paga

31.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, pas mbylljes së hetimit administrativ në Komision, ka arritur të marrë, pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimit Shëndetësor në Tiranë, nga dosja e pensionit të tij si ushtarak, vërtetimin nr. {***} prot., datë 23.11.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vjetërsinë e shërbimit dhe pagën mesatare neto referuese. Sipas këtij vërtetimi, paga neto e subjektit nga data 01.04.1993 deri më datë 20.06.1993 ka qenë 54.522 lekë, ndërsa nga data 20.06.1993 deri më datë 16.09.1993 ka qenë 57.885 lekë. Subjekti kërkon që kjo provë, të cilën nuk ka pasur mundësi ta paraqesë më parë, jo për fajin e tij, të administrohet dhe të vlerësohet nga Kolegji si provë e re në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, dhe këto të ardhura të pasqyruara në këtë dokument të përfshihen në analizën e tij financiare për vitin 1993.

31.1/a. Në analizë të pretendimit të subjektit, se ka qenë në pamundësi për të paraqitur më parë vërtetimin nr. {***} prot., datë 23.11.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për vjetërsinë e shërbimit dhe pagën mesatare neto referuese, konstatojmë se, për sa kohë ky dokument nuk është prodhuar pas daljes së vendimit të Komisionit, si dhe subjekti ka pasur të gjithë kohën e nevojshme për gjetjen dhe administrimin e dokumentacionit për të provuar burimet e ligjshme të pasurisë së tij, nuk mund të konsiderohet se subjekti ka qenë në kushtet e pamundësisë objektive, për paraqitjen e tij në Komision, sipas parashikimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

31.1/b. Pavarësisht këtij fakti, për të krijuar një pasqyrë sa më të qartë mbi të ardhurat e subjektit në vite, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare, duke përfshirë të ardhurat e pasqyruara në vërtetimin nr. {***} prot., datë 23.11.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, dorëzuar nga subjekti bashkë me ankimin, ku për vjetërsinë e shërbimit dhe pagën mesatare neto referuese, për vitin 1993, subjekti është paguar si vijon: për periudhën 01.04.1993 – 20.06.1993, paga neto/muaj 5.452,2 lekë, në total 16.356 lekë, për periudhën 20.06.1993 – 31.12.1993 paga neto/muaj 5.788,5 lekë, në total 34731 lekë. Shuma totale e të ardhurave të përfituara nga paga për subjektin e rivlerësimit për vitin 1993 do të rezultonte në vlerën 51.087 lekë, duke iu zbritur këtyre të ardhurave shpenzimet e jetesës për vitin 1993, atëherë të ardhurat e kursyera për vitin 1993, të cilat mund të përfshihen në analizën financiare të subjektit, do të ishin në vlerën 35.761 lekë.

Referuar sa më lart, edhe sikur të përfshihen në analizën financiare vlerat maksimale të kursyera nga subjekti në vitin 1993, ai do të rezultonte me një balancë negative prej - 4.693.781 lekësh, për periudhën 1993 – 2002.

31.1/c. Në konkluzion të analizimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat nga paga, të pasqyruara në këtë dokument për vitin 1993 dhe të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për t’u përfshirë në analizën financiare të tij, janë në vlera minimaliste dhe kanë ndikim të papërfillshëm në balancën negative të subjektit të rivlerësimit, për periudhën 1993 – 2002. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se dokumenti vërtetim nr. {***} prot., datë 23.11.2018, i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, konsiderohet një akt, marrja e të cilit duket se është e panevojshme dhe nuk ndikon në vendimmarrjen e kësaj çështjeje bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

31.2. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se analiza financiare e tij është bërë për vitet 1995 – 2016, duke mos përfshirë të ardhurat nga paga për vitin 1994. Subjekti kërkon që në analizën në Kolegj të përshihen të ardhurat nga paga në vitin 1994, pasi sipas shkresës nr. {***} prot., datë 28.10.2016, të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, të cilën e ka dorëzuar së bashku me deklaratën *vetting* dhe të ardhurat nga paga në vitin 1994 kanë qenë në shumën 80.736 lekë. Trupi gjykues, pas kontrollit të analizës financiare të Komisionit dhe pas kontrollit të analizës financiare të detajuar për çdo vit, konstaton se, në zërin “të ardhura të përfituara nga paga”, për periudhën 1995 – 2016, janë përfshirë edhe të ardhurat e përfituara nga paga për vitin 1994, në shumën prej 80.736 lekësh, sipas vërtetimit me nr. {***} prot., datë 28.10.2016, të lëshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut, Tiranë, për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

32. Në lidhje me udhëtimet jashtë shtetit

32.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, pas mbylljes së hetimit administrativ, Drejtoria e Arkivit në Ministrinë e Brendshme i ka dërguar atij, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 01.08.2022, kopje të urdhrave të Ministrit të Brendshëm, konkretisht urdhri nr. {***}, datë 16.09.2009, për dërgim me shërbim në Budva, Mali i Zi, dhe urdhri nr. {***}, datë 26.10.2009, për dërgim me shërbim në Nova Gorica, Slloveni. Subjekti i rivlerësimit kërkon që këta urdhra të administrohen nga Kolegji si provë e re, duke u reflektuar në tabelën e shpenzimeve të tij për udhëtimet jashtë shtetit. Gjithashtu, subjekti kërkon të merret në konsideratë informacioni i shkresës së mësipërme, sipas së cilës për vitet 2006 – 2008, nuk ka të dhëna arkivore dhe ta konsiderojë si pamundësi objektive të subjektit të sigurimit të provave për shpenzimet e shërbimeve jashtë shtetit, për periudhën 2006 – 2008.

32.2. Në analizë të pretendimit të subjektit, trupi gjykues konstaton se në seancën dëgjimore subjekti ka paraqitur, ndër të tjera, një *email* (jozyrtar), nga përgjegjësi i Sektorit të Financës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, i cili përmban të dhëna në formë tabelare lidhur me pagesën e shërbimeve të kryera jashtë vendit, në periudhën 2006 – 2009, nga subjekti i rivlerësimit, sipas mandatpagesave të likuiduara nga Ministria e Brendshme. Nga kontrolli i analizës së shpenzimeve të udhëtimit të përlllogaritur nga Komisioni, si edhe referuar shkresave të dorëzuara nga subjekti me ankimin, trupi gjykues konstaton se shpenzimet e udhëtimeve, për të cilat janë lëshuar urdhrat e sipërcituar, janë zbritur nga shpenzimet e udhëtimit të përlllogaritura nga Komisioni, pas rezultateve të hetimit, bazuar në *email*-in jozyrtar të dërguar nga përgjegjësi i Sektorit të Financës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe shuma e totale e shpenzimeve të udhëtimit në vendim, për vitin 2009, është 294.916 lekë.

32.3. Gjithashtu, ky fakt konstatohet edhe nga analizimi i vendimit të Komisionit,⁵⁴ ku rezulton se, në përfundim të analizës financiare, sa i përket udhëtimeve të subjektit të kryera për shkak të detyrës, së periudhës 2006 – 2009, citohet se: *ndonëse dokumenti i paraqitur prej subjektit nuk është i firmosur apo vulosur nga institucioni përkatës, Komisioni ka vlerësuar të pranojë kërkesën e tij, por vlen të theksohet se kjo rrethanë nuk impakton rezultatin final të analizës financiare, duke qenë se analiza e këtyre viteve ka rezultuar me balancë pozitive*. Sikurse vërehet, Komisioni i ka marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për shpenzimet e udhëtimeve jashtë shtetit për vitet 2006 – 2009 dhe i ka reflektuar ato në tabelën e shpenzimeve, por, për sa kohë në këto vite subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë pozitive, trupi gjykues e vlerëson se kjo rrethanë nuk e impakton rezultatin final të analizës financiare.

⁵⁴ Paragrafi 104 dhe 106, faqe 29 e vendimit të Komisionit.

33. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, që në rastin e tij të aplikohet parimi i proporcionalitetit, trupi gjykues çmon të theksojë se parimi i proporcionalitetit⁵⁵ dhe i objektivitetit nuk mund të zbatohen në rastet kur konstatohen, jo vetëm një, por disa problematika domethënëse, parimi i proporcionalitetit nuk mund të shërbejë për anashkalimin e vetë qëllimit për të cilin është ngritur procesi i rivlerësimit dhe zbatimit korrekt të ligjit të posaçëm. Parimi i proporcionalitetit, parashikuar në pikën 1, të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, ka për qëllim që masa disiplinore të jetë në proporcion me shkeljen e konstatuar. Sikurse ka arsyetuar Kolegji në vendime të mëparshme,⁵⁶ proporcionaliteti është një pjesë e tërësisë së parimeve nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit dhe nuk mund të gjejë zbatim si parim i veçantë dhe i vetëm i procesit të rivlerësimit. Për pasojë, pamjaftueshmëria financiare e subjektit, e konstatuar nga Komisioni, megjithëse e reduktuar në Kolegji, përsëri mbetet në nivele që nuk lejojnë zbatimin e parimit të proporcionalitetit. Trupi gjykues e gjen jorelevante, por edhe të pasaktë referimin e subjektit të rivlerësimit në vendimin e Kolegjit nr. 6/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit H. K., për aplikimin e parimit të proporcionalitetit, pasi jo vetëm shuma e konstatuar si mungesë burimesh financiare, për periudhën 1996 – 1997, e z. K., është disa herë më e vogël se ajo e subjektit Astrit Halilaj, por subjekti i rivlerësimit H. K. nuk ka qenë subjekt deklarues në vitet për të cilat rezulton me balancë negative. Për më tepër, që z. K. për të ardhurat nga avokatia, kishte prova të mjaftueshme që i vërtetonin ato, në dallim nga mungesa e dokumentacionit justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit Astrit Halilaj, për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.
34. Trupi gjykues, pasi kontrollon analizën financiare të Komisionit, çmon se balanca negative e subjektit të rivlerësimit, e konstatuar nga Komisioni dhe e konfirmuar në Kolegji, për periudhën përpara vitit 2003, mbetet në vlerën prej 4.729.542 lekësh. Për vitet 2003 – 2016, duke konsideruar disa nga pretendimet e subjektit lidhur me rishikimin e disa zërave të analizës financiare, balanca negative nga 5.002.460 lekë, e konstatuar nga Komisioni, reduktohet në vlerën 4.334.836 lekë, duke çuar në një balancë totale negative prej 9.064.378 lekësh, e cila përsëri është në një vlerë të konsiderueshme. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në këto vite, situatë kjo që kualifikohet sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
35. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke u gjendur në këtë mënyrë në një prej rasteve të parashikuara për vendosjen e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” dhe, për pasojë, vendimi nr. 545, datë 30.06.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

⁵⁵ Analizuar në mënyrë të detajuar në paragrafin nr. 25 të këtij vendimi.

⁵⁶ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit që u përkasën subjektit të rivlerësimit B. C., nr. 2/2020 (JR), datë 27.02.2020, subjektit të rivlerësimit F. L., nr. 20/2020 (JR), datë 08.09.2020 dhe subjektit të rivlerësimit SH. C., nr. 36/2020 (JR), datë 16.12.2020.

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 545, datë 30.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Astrit Halilaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 13.05.2025.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi